

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS “EKONOMI”



Program orientues

Koordinator:
Astrit Dautaj

2024-2025




TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AML	21
Përmbajtja e programit orientues për orën e hapur mësimore	26
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.....	36
PROJEKTI KURRIKULAR	44




HYRJJE

Roli i mësuesit shtrihet përtej mësimdhënies dhe në veçanti roli i mësuesit të ekonomisë është i rëndësishëm për shkak të natyrës sfiduese të kësaj fushe. Ai ndikon në krijimin e një mjedisi pozitiv mësimor, zhvillimin e mendimit kritik dhe nxitjen e motivimit për të mësuar. Mësuesit që përdorin teknika efektive mësimore, të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, arrijnë të maksimizojnë potencialin e çdo nxënësi. Një marrëdhënie e mirë mes mësuesit dhe nxënësit krijon një ndjenjë sigurie dhe përkatësie që rrit motivimin dhe angazhimin në mësim. Mësuesit që janë të aftë të identifikojnë vështirësitë individuale dhe t'u japin mbështetje të personalizuar nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike. Mësuesit shpesh janë shembuj për nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në njohuritë mësimore, por edhe në vlerat dhe sjelljet që ata përvetësojnë.

Ekonomia kërkon të menduarit kritik për zgjidhjen e problemeve dhe analizimin e situatave komplekse. Një mësues i aftë mund t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të menduar logjikisht dhe për të zbërthyer problemet në hapa të qartë. Mësuesi duhet të jetë i aftë të përdorë metoda të ndryshme për të shpjeguar konceptet e vështira. Kjo mund të përfshijë përdorimin e mjeteve vizuale, shembujve praktikë, lojërave apo aplikimeve në jetën reale që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet abstrakte. Ekonomia ndërtohet mbi konceptet e mëparshme. Një mësues i mirë i ekonomisë e di se duhet të fillojë nga bazat dhe të krijojë një strukturë logjike për të avancuar me koncepte më të përparuara. Kjo siguron që nxënësit të kenë një themel të fortë dhe të mos ndihen të mbingarkuar. Një mësues i mirë i ekonomisë mund të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në fusha të caktuara dhe të japë mbështetje shtesë për ta.

Shpesh ekonomia shihet si lëndë e vështirë. Mësuesi duhet të krijojë aktivitete dhe sfida që nxësin kureshtjen e nxënësve, duke e lidhur ekonominë me situata praktike nga jeta e përditshme ose me fushat që ata i pëlqejnë. Mësuesi i ekonomisë mund të përfitojë nga përdorimi i programeve kompjuterike, aplikacioneve dhe platformave edukative që ndihmojnë nxënësit të praktikojnë konceptet dhe të zgjidhin probleme me ritmin e tyre.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- 
- për kandidatët e kategorisë “**Mësues i kualifikuar**”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet a) dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, b) vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe c) vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
 - për kandidatët e kategorisë “**Mësues specialist**”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet a) dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, b) vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe c) vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
 - për kandidatët e kategorisë “**Mësues mjeshtër**”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet a) dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe b) vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së ekonomisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së ekonomisë në për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, qasjen STEM etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e ekonomisë në: *arsimin e mesëm të lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, modele orësh mësimore për lëndën e ekonomisë në *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat që lidhen me zhvillimin e projektit kurrikular, modeli i projektit kurrikular në *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie;
- aspekte të etikës;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të ekonomisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të ekonomisë është strukturuar sipas fushave kryesore të përmendura më sipër të zhvillimit profesional, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë

bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së qytetarisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit, si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së qytetarisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhet me secilën fushë/lëndë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

Fusha: Programe lëndore	
Rezultati	Literatura
Mësuesi do të jetë i aftë:	
- të përcaktojë çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë për nxënësit; - të analizojë karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës; - të vlerësojë zbatimin cilësor të programit: kërkesat ndaj mësuesit si zbatues i programit lëndor; - të vërë në dukje të rishikimi i programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose përmirësimit të programit lëndor; - të dallojë strukturën e programit lëndor dhe të përshkruajë përmbajtjen e rubrikave të saj; - të përshkruajë lidhjet ndërmjet njohurive të lëndës që jep mësim me	- Korniza Kurrikulare, 2014. - Programi i lëndës “Ekonomia” për gjimnazin, për arsimin profesional dhe për arsimin e orientuar (social – kulturor). - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X-XII.

njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë.	
Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie	
Rezultati	
Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
- të zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep; - të zhvillojë koncepte dhe metoda që e bëjnë nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja; - të jetë i hapur për bashkëpunim dhe vlerësim të punës që bën; - të dallojë pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar; - të hartojë objektiva të nxëni; - të dallojë dhe të hartojë objektiva arritjeje në nivele të ndryshme; - të zbatojë njohuritë e tij për krijimin e një klime të përshtatshme të mësuarit në klasë; - të dallojë dhe të përzgjedhë metoda dhe teknika të përshtatshme me objektivat e të mësuarit dhe stilet e ndryshme të të mësuarit; - të strukturojë një ditar dhe të tregojë qëllimin e rubrikave të tij; - të përcaktojë synimet ose objektivat e kurrikulës në përputhje me filozofinë arsimore të përzgjedhur;	- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016. - Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018. - Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. - Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021. - Materiale ndihmëse për edukimin qytetar https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/ Demokracia në veprim

- të alternojë metodat e punës individuale dhe asaj në grup në varësi të objektivave të të mësuarit;
- të zbatojë teknika dhe forma të ndryshme të vlerësimit të nxënit;

<https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/> .

Vëllimi 1

- Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit (faqe 60-64).
- Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve (faqe 65-72).
- Drejtimi i procesit të të nxënit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies (faqe 81-82, 87-88, 90-92).
- Manuali për edukimin e qytetarisë digjitale i Këshillit të Evropës
- Materiale ndihmëse për edukimin qytetar

<https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/>

faqe 11-15.

- Udhëzues Për mësimdhënien dhe të mësuarit e edukimit për kulturë demokratike:

41-48, 56-60, 61-116,

- www.ascap.edu.al

Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit	
Rezultati	Literatura
Mësuesi do të jetë i aftë:	
- të përshkruajë parimet themelore mbi të cilat është hartuar kodi i etikës së mësuesit; - të dallojë sjelljet e mësuesit që burojnë nga parimet themelore; - të hartojë vetë një kod të thjeshtë sjelljeje që bazohet në parimet dhe standardet e kodit të etikës; - të përshkruajë sjelljet model që duhet të karakterizojnë zbatuesit e kodit të etikës së mësuesit, në varësi të funksionit që ka në komunitetin e shkollës; - të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar” .
Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	
Rezultati	Literatura
Mësuesi do të jetë i aftë:	
të zbatojë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe standarde.	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndës

Nr.	Tematika	Rezultatet e pritshme	Literatura
1.	Çfarë studion ekonomia?	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune; - të japë shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj; - të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim; - të interpretojë një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj të ilustrojë koston oportune”; - të vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor; - të përshkruajë veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë; - të përshkruajë rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë; - të analizojë se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor; - të përshkruajë fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut.	Tekste për nxënësin për lëndën ekonomi, literaturë shkencore dhe burimore për përmbajtjen e lëndës.

2.	Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut.	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> • të interpretojë konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë; • të formulojë ligjin e kërkesës dhe ofertës; • të interpretojë lakoren e kërkesës dhe ofertës; • të shpjegojë faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; • të përcaktojë çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut; • të bëjë dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar, apo ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë apo ofertë; • të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar; • të shpjegojë se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe në ofertë; • të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër; • të shpjegojë se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre; • të vlerësojë se si sistemi i tregut siguron plotësimin e nevojave të konsumatorëve; • të dallojë çmimin tavan nga çmimi dysHEME;	
----	-------------------------------------	---	--

		- të shpjegojë se si ndërhyrja e qeverisë mund të ndikojë tek tregu dhe sesi çmimet e tregut ofrojnë informacion dhe nxitje për konsumatorët dhe prodhuesit; - të analizojë raportin kosto-përfitim lidhur me ndërhyrjen e qeverisë në përcaktimin e çmimit të disa produkteve.	
3.	Konsumatori në ekonominë e tregut	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre; - të shpjegojë arsyet pse njerëzit kursejnë; - të krahasojë metodat e ndryshme të kursimit; - të analizojë faktorët që ndikojnë në masën e kursimit; - të përgatisë një buxhet personal; - të shpjegojë avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi.	
4.	Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të shpjegojë se si tregu i lirë inkurajon sipërmarrjen; - të listojë format kryesore të organizimit të biznesit; - të gjykojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; - të shpjegojë organizimin e korporatës;	

		• të gjykojë mbi disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; • të dallojë burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit; • të shpjegojë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit; • të dallojë ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit; • të analizojë një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.	
5.	Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> • të bëjë dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël; • të llogarisë koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale; • të interpretojë grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale; • të llogarisë të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare; • të llogarisë produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar; • të zbulojë veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit; • të shpjegojë funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër.	

6.	Struktura e tregut	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> • të interpretojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; • të identifikojë nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi; • të shpjegojë karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol; • të diskutojë raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve; • të krahasojë strukturat e ndryshme të tregjeve; • të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin; • të argumentojë se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjithë subjekteve në ekonominë e tregut.	
7.	Tregjet e faktorëve të prodhimit	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> • të interpretojë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit; • të interpretojë ofertën për punë dhe kërkesën për punë; • të shpjegojë se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës; • të vlerësojë shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.	

8.	Qeveria dhe ekonomia	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të shpjegojë funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut; - të shpjegojë pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve; - të përshkruajë disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare; - të shpjegojë arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm; - të vlerësojë taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre; - të krahasojë tipat e ndryshme të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale; - të interpretojë konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre; - të analizojë përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik; - të përshkruajë një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor.	
9.	Paraja dhe institucionet financiare	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të interpretojë konceptin e parasë dhe karakteristikat e saj dhe funksionet e parasë në një ekonomi monetare; - të përshkruajë procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë duke evidentuar format e saj;	

		- të identifikojë tipat e parasë në qarkullim, në vendin tonë; - të shpjegojë: ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si pranuese depozitash dhe dhënëse huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare; - të përshkruajë organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë.	
10.	Treguesit kryesorë makroekonomikë	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të përcaktojë treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë; - të shpjegojë konceptin e GDP-së dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP-së; - të bëjë dallimin midis GDP-së reale dhe GDP-së nominale; - të analizojë kuptimin e GDP-së për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; - të përshkruajë metodat e matjes së GDP-së; - të japë kuptimin për inflacionin, deflacionin; - të dallojë inflacionin e shkaktuar nga kostoja nga inflacioni i shkaktuar nga kërkesa; - të shpjegojë ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit; - të shpjegojë fazat kryesore të ciklit të biznesit;	

		- të shpjegojë konceptin e forcës punëtore; - të dallojë format kryesore të papunësisë.	
11.	Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të përshkruajë mjetet e politikës fiskale; - të shpjegojë pse politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria; - të interpretojë efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të politikës fiskale në papunësinë, prodhimin dhe normat e interesit; - të përshkruajë instrumentet e politikës monetare; - të dallojë instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale; - të përshkruajë ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare; - të identifikojë rrugët në të cilat politika monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit.	
12.	Tregtia ndërkombëtare	<i>Mësuesi të jetë i aftë:</i> - të shpjegojë konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese; - të argumentojë përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbëjnë midis tyre; - të analizojë përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj;	

		• të përshkruajë disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare; • të japë në mënyrë të përmbledhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë; • të përshkruajë pse luhaten kurset e këmbimit valutor; • të bëjë dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar.	
--	--	--	--

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AML

A. PROGRAMI LËNDOR

Pyetje 1

Kurrikula në bazë shkolle synon kryesisht:

- A) të unifikojë arsimin në nivel kombëtar.
- B) të vendosë kritere për të matur arritjet e nxënësve në nivel vendor .
- C) t'u ofrojë nxënësve mundësinë për të përfutur përvoja të reja arsimore.
- D) të pajisë nxënësit me aftësitë e nevojshme për punësim në nivel vendor.

Pyetje 2

Rezultati i pritshëm i të mësuarit “Nxënësi përshkruan marrëdhëniet ndërmjet edukimit për median dhe informimin, qytetarisë dhe demokracisë” lidhet me njërin prej kompetencave të mëposhtme. Rezultati i pritshëm i mësipërm, lidhet më shumë me:

- A) të kuptuarit e rolit të medias dhe të informacionit në demokraci.
- B) të kuptuarit e përmbajtjes së medias dhe të përdorimit të saj.
- C) sigurimin me cilësi dhe rendiment të informacionit.
- D) vlerësimi kritik i informacionit dhe i burimeve të tij.

B. ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

Pyetje 3

Lidhur me kompetencën e mësuesit për të zotëruar përmbajtjen e materialit mësimor, ka më shumë nevojë për trajnim mësuesi që:

- A) mbështetet tek teksti mësimor dhe udhëzuesi i mësuesit për të zhvilluar mësimin.
- B) është në dijeni të zhvillimeve dhe të materialeve të reja që lidhen me lëndën.
- C) paraqet gjithnjë informacion të besueshëm dhe që lidhet me lëndën dhe me temën konkrete që trajton.
- D) asnjë nga të mësipërmet.

Pyetje 4

Ju, si mësues keni vendosur të përdorni **median** në një orë mësimore për të rritur vetëdijen e nxënësve tuaj, jo vetëm për mundësitë që ofron media në fushën e edukimit, por edhe për rreziqet që bart. Shkruani 3 objektiva të mësuarit (pritshmëri në tri nivele arritjeje) që ju synoni të arrini përmes një orë mësimore.

Për të shmangur konfliktet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve në fushën e vlerësimit mësuesi duhet:

- A) të bindë nxënësit në drejtësinë e vendimit të tij.
- B) të mos lejojë diskutime me nxënësit për notën e vënë.
- C) të bëjë të qarta që në fillim kriteret e vlerësimit të nxënësve.
- D) të rishikojë vendimin e tij.

Pyetje 5

Për të parandaluar ose për të pakësuar në mënyrë të efektshme paragjykimet në klasën e tyre, mësuesit:

- A) duhet të jenë model i sjelljeve dhe qëndrimeve pa paragjykime.
- B) duhet t'i kushtojnë për një kohë të caktuar trajtimit të çështjeve të pakicave.
- C) duhet të dënojnë fëmijët që shfaqin paragjykime .
- D) duhet të shpërfillin si të parëndësishme shprehjet e paragjykimeve dhe të njëanshmërive në klasë.

C. ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

Pyetje 6

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

D. ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Pyetje 7

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) viti 11-të i shkollës
- B) viti i 11 i shkollës
- C) viti i 11-t i shkollës
- D) viti i 11-të i shkollës

E. PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Pyetje 8

Në qoftë se niveli i pagës vendoset mbi pagën e ekuilibrit, në tregun e punës do të kemi:

- A) një tepricë kërkesë për punë.
- B) një tepricë ofertë për punë.
- C) nuk kemi as tepricë as kërkesë për punë.
- D) kemi dhe tepricë dhe kërkesë për punë.

Pyetje 9

Kur kërkesa për kompjuter rritet, të njëjtën gjë bën dhe kërkesa për programe kompjuterësh. Ekonomistët thonë se kompjuterët dhe programet kompjuterike janë:

- A) të mira normale
- B) të mira zëvendësuese
- C) të mira plotësuese
- D) të mira inferiore

Pyetje 10

Në një ekonomi mikse, ndërhyrja e shtetit është e justifikuar nëse:

- A) cilësia e disa produkteve nuk është e lartë.
- B) çmimi i disa produkteve është tepër i lartë.

- C) duhen investime në infrastrukture.
- D) qytetaret kërkojnë produkte të reja në treg.

Pyetje 11

Lidhja që na tregon sasinë maksimale të prodhimit të përfituar me një sasi të dhënë të burimeve të prodhimit quhet funksioni:

- A) i ofertës
- B) i kostos
- C) i prodhimit
- D) i dobishmërisë

Pyetje 12

Altini zotëron një apartament në qendër të Tiranës, kurse Iliri një vilë në periferi. Nëse duam t'i krahasojmë këto dy banesa me njëra-tjetrën, cila nga funksionet e parasë do të na shërbente:

- A) paraja si mjet këmbimi;
- B) paraja si matëse e vlerës;
- C) paraja si ruajtëse e vlerës;
- D) paraja si mjet likuiditeti.

Pyetje 13

Stabilizuesit 'automatik' quhen të tillë sepse hyjnë në veprim:

- A) pa ndërhyrjen e qeverisë;
- B) me ndërhyrjen e qeverisë;
- C) me ndërhyrjen e Bankës Qendrore;
- D) me ndërhyrjen e sindikatave të punëtorëve.

Pyetje 14

Norma bazë e interesit e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë prek fillimisht:

- A) qytetarët

- B) kompanitë private
- C) bankat tregtare
- D) qeverinë

Pyetje 15

Inflacioni matet me:

- A) të ardhurat e individëve;
- B) indeksin e çmimeve të konsumatorëve;
- C) me prodhimin kombëtar të mallrave dhe shërbimeve;
- D) me normën e interesit për një periudhë të caktuar.

Pyetje 16

Bledi është informaticien pranë një banke të nivelit të dytë. Paga e tij është më e lartë se e motrës së tij që punon si ekonomiste në një firmë. Të dy paguajnë një taksë 10% mbi të ardhurat. Ky është shembull i një:

- A) sistemi taksë regressive;
- B) sistemi taksë progresive;
- C) sistemi taksë proporcionale;
- D) taksë të bazuar në parimin e përfitimit.

Përmbajtja e programit orientues për orën e hapur mësimore

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmeneduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

Modele orësh mësimore për secilin nivel

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për AML. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

Veprimtari 1

Tema: Ndal është jeta ime

Qëllimi

Kjo veprimtari mund të zhvillohet në kuadrin e një ore që mund të ketë si objektiv trajtimin e ndryshimeve kulturore dhe subkulturore të njerëzve dhe rëndësisë së njohjes, të vlerësimit dhe të respektimit të tyre për përmirësimin e cilësisë së marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në veçanti. Po kështu, kjo veprimtari krijon mundësi për trajtimin e rëndësisë që ka njohja e veçorive të secilit për parandalimin ose zgjidhjen e konflikteve.

Përveç kësaj kjo veprimtari është edhe një shembull i përdorimit të llojeve të ndryshme të objektivave në fushën e edukimit të të drejtave të njeriut të trajtuar më sipër.


Kjo veprimtari synon:

- të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e njohjes së karakteristikave të tjetrit:
 - për krijimin e harmonisë në marrëdhëniet shoqërore;
 - për parandalimin e konflikteve që lidhen me mosrespektimin e veçorive të secilit;
 - për të ndihmuar të tjerët në raste fatkeqësish, traumash, apo vështirësish të natyrave të ndryshme;
- të aftësojë nxënësit të marrin parasysh veçoritë individuale dhe ato të jetës private në komunikimin e tyre të përditshëm në shoqëri.

Rezultatet e pritshme të të mësuarit:

Në fund të këtij aktivitetit nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë mes të drejtave të shumta, të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (njohja);
- të lidhë standardin me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit (kontekstualizimi);

- 
- të tregojë, përmes vendimmarrjes, rëndësinë e respektimit të jetës private të tij dhe të të tjerëve, duke marrë parasysh kulturën, zakonet, traditat etj. (zbatimi).

Koha: 45'

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë

Mësuesi u jep nxënësve situatën e mëposhtme:

Mendoni veten në rolin e një gazetari që cili kërkon të intervistojë tri personazhe femra për jetën e tyre private. Personazhet ndodhen në:

- *Shqipëri*
- *SHBA*
- *Filipine*

Mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë tri pyetje që do ua drejtojnë personazheve në fjalë. Pasi secili nxënës shkruan pyetjet në një letër, ata e kthejnë letrën përmbys.

Hapi i dytë

Në këtë fazë mësuesi kërkon nga nxënësit të mendojnë në mënyrë individuale dhe më pas të radhitin në një fletë të bardhë:

- 3 gjëra që *lehtësisht* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra që me *vështirësi* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra të cilat nuk do të dëshironin t'i bisedonin me të tjerët, duke iu quajtur vetjake.

Hapi i tretë

Pas kësaj klasa ndahet në grupe dhe secilit grup i kërkohet të diskutojë e të marrë vendim për të bërë ndarjen e mësipërme.

Pasi nxënësit të kenë realizuar detyrën, mësuesi ndërton, në tabelë ose në një tabak të madh letre kolonat e mëposhtme:

Të thjeshta për t'i diskutuar me të tjerët	Të vështira për t'i diskutuar me të tjerët	Private

Më pas ai dëgjon raportimet e grupeve dhe bën plotësimet sipas kolonës.

Hapi i katërt

Mësuesi dialogon me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjet e mëposhtme:

- *Përse disa gjëra diskutohen lehtë me të tjerët e të tjera jo?*
- *Cilat janë të përbashkëtat për secilën kategori në ndarjet tuaja?*
- *Si e shpjegoni faktin që të njëjtat gjëra i shohim në tituj të ndryshëm (një vajzë i tregon nënës, një tjetër jo)?*
- *A mund të ketë një ndarje fikse në qëndrimet e njerëzve për të njëjtat gjëra? Pse ekzistojnë konceptime të ndryshme për gjërat private? Cilët janë faktorët që ndikojnë në të?*
- *A ndikon kjo edhe në mënyrën se si njerëz të ndryshëm përjetojnë situata të njëjta ose të ngjashme?*

Gjatë diskutimit mësuesi e përqendron vëmendjen e nxënësve te rëndësia që ka respektimi i individualitetit të secilit kur bëhet fjalë për çështje që prekin ndjenjat, hapësirat e jetës private të njerëzve të cilat siç e pamë lidhen ngushtë me prejardhjen e tij psiko-kulturore, familjare, me statusin e tij social etj.

Hapi i pestë

Reflektim.

Në këtë fazë, mësuesi fton nxënësit një proces reflektimi duke zhvilluar pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë të drejtat e njeriut që përfshihen në këtë rast studimor?
- Si e kuptoni ju të drejtën për një jetë private?
- Nga varet realizimi i të drejtës për një jetë private? Çfarë e rrezikon atë?

- Nëse ekzistojnë kufij të respektimit të jetës private, në ç ‘raste duhet të vendosen ata (a mund të jenë kufijtë e njëjtë)?
- Cilat janë përfundimet që mund të nxirren nëse kjo çështje trajtohet?
 - Si çështje ligjore;
 - Si çështje kulturore;
 - Si çështje që lidhet me parandalimin e konfliktit etj..

Në fund mësuesi fton nxënësit të lexojnë pyetjet që bënë në fillim të orës së mësimi dhe u drejton atyre pyetjen:

A do të shkruanit të njëjtat pyetje pas kësaj ore mësimi? Përse?

A ka ndonjë nxënës që nuk i ka shkruar pyetjet menjëherë ose që ka kërkuar informacion shtesë...?

Vlerësimi

Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të aftësisë së tyre për :

- të dalluar, identifikuar mes të drejtave të shumta , të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (*njohja*),
- të lidhur standardin (të drejtat dhe “kufijtë”) që lidhen me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit(*kontekstualizimi*),
- të treguar rëndësinë e marrjes parasysh të kulturës të zakoneve, personalitetit etj., përpara se të marrin një vendim ose qëndrim që lidhet me respektimin e diversitetit etj. (zbatimi).

Veprimtari 2

Tema: Manipulimi i informacionit: Verifikoni dhe kushtojini rëndësi përpara se ta shpërndani

Qëllimi

Në këtë orë mësimore, nxënësit do të njihen me mundësinë e manipulimit të informacionit; me mundësinë e ndeshjes me informacionet e manipuluar dhe pasojat e mundshme që ato kanë në vendimmarrjet e tyre dhe të individëve në përgjithësi. Ata do të njihen me konceptet kryesore që lidhen me manipulimin e informacionit dhe format e shfaqjes së tyre në media.

Nxënësve u jepet mundësia të diskutojnë për pasojat e mundshme që ka manipulimi i informacionit për individin, grupi dhe shoqërinë dhe për këtë arsye, për rëndësinë që ka njohja dhe identifikimi i informacioneve manipuluese dhe i faktorëve që i krijojnë, i mbajnë gjallë dhe i përhapin dhe, për rrjedhojë, edhe për përgjegjësinë që duhet të ketë çdo individ që lufton për një shoqëri demokratike për ta identifikuar dhe ndaluar përhapjen e informacioneve manipuluese në të gjitha format e shfaqjes së tyre.

Suksesi i kësaj lufte varet jo vetëm nga njohja e dukurisë dhe e faktorëve që e krijojnë dhe e mbajnë gjallë, por edhe algoritmi, modeli e radha e veprimeve që duhet të ndjekë çdo individ në këtë drejtim.

Përveç kësaj, kjo veprimtari synon të sfidojë nxënësin si një krijues ose përhapës i mundshëm, me vetëdije ose jo, i informacioneve të manipuluar dhe i dialogut/reflektimeve që ai duhet të bëjë me veten përpara se kjo mundësi të kthehet në realitet.

Rezultatet e pritshme të të mësuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë përmbajtjen e konceptit manipulim i informacionit dhe i formave të shprehjes së tij;
- të përmendë disa nga faktorët që krijojnë ose mbajnë gjallë format e çrregullimit të informacionit, kushtet që krijojnë terrenin e përshtatshëm për këta faktorë dhe pasojat e tyre për individin, grupin dhe shoqërinë;

- të identifikojë disa nga hapat që ai duhet të ndërmarrë kur ndeshet me një informacion, si hapi i parë drejt krijimit të një algoritmi (modeli) të qëndrueshëm për t'u zbatuar në rastet kur përballlet me informacione të reja (ose edhe të vjetra, të para në kohë dhe hapësirë tjetër).

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë 6-7 minuta

Mësuesi u kërkon nxënësve të kujtojnë raste kur janë ndeshur me informacione që më vonë kanë dalë të gabuara si dhe rastet kur ata kanë marrë vendime mbi bazën e këtyre informacioneve. Ai u kërkon atyre të thonë disa nga llojet e pasojave të këtyre vendimeve për ta (për veten, familjen, grupin ku bëjnë pjesë etj.) Mësuesi shënon në tabelë ose në dërrasën e zezë përgjigjet e nxënësve për pasojat e vendimeve.

Në vijim mësuesi kërkon prej nxënësve të përmendin disa nga burimet e këtyre informacioneve të gabuara për shembull nga lajmet, platformat sociale që përdorin etj.) dhe sa shpesh marrin vendime mbi bazën e informacioneve që marrin prej tyre.

Mësuesi u kërkon nxënësve të përmendin edhe burime të tjera nga kanë marrë informacionet e gabuara në lagje, shkollë etj.

Hapi i dytë 15 minuta

Mësuesi u paraqet nxënësve tabelën e mëposhtme dhe u shpjegon atyre përmbajtje e koncepte që përshkruhen aty.



Në vijim mësuesi i fton nxënësit të mendojnë për çështjet që lidhen me secilin prej koncepteve:

1. Keqinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Përse mund të ndodhin keqinformimet?
- Cilat janë disa nga pasojat e keqinformimit?

2. Dezinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Cilat mund të jenë disa nga shkaqet që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e dezinformimit?

3. Informim keqdashës

- Si shprehen informacionet keqdashëse?
- Cilat janë disa nga shkaqet e mundshme që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e informimit keqdashës?

Mësuesi shënon në tabelë pasojat e mundshme për secilin rast.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjen e mëposhtme dhe, për disa minuta, nxit diskutimin e klasës rreth saj?

- Çfarë duhet të bëjmë për të mos qenë viktima të manipulimit të informacionit?

Hapi i tretë 15-17 minuta

Mësuesi ndan klasën në grupe. Secilit grup i jep detyrën të lexojnë një prej lajmeve në tabelën e mëposhtme.

Më tej ai kërkon prej tyre të verifikojnë lajmin duke u përgjigjur pyetjeve që ndodhen në tabelën e verifikimit të informacionit.

Pyetje për verifikimin e informacionit		
1	Kush e ka krijuar mesazhin?	
	A është ky burim i besueshëm?	
2	Si përpiqet mesazhi ta mbërthejë vëmendjen time?	
	A përdor germa shtypi?	
	A përdor imazhe të forta?	
3	Përse mendoni se është krijuar ky mesazh?	
	Çfarë lloj veprimi mendoni se autori i mesazhit kërkon që ju të bëni pasi ta lexoni atë?	
4	Kur u publikua mesazhi?	
	A e ka datën?	
	A ka datë të gabuar?	
	A ka datë të vjetër?	
5	Si u ndjetë nga ky mesazh?	
	A mendoni se edhe të tjerët mund të kenë të njëjtat ndjesi si ju?	



Në fund grupet ndajnë përfundimet e tyre.

Reflektim 5 minuta

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë për:

1. Përgjegjësinë e çdo individit për të përcjellë gjithmonë informacione të vërteta.
2. Përgjegjësinë e çdo individit që të aftësohet përmes shkollës që të dallojë gjithmonë çrregullimet e informacionit.
3. Përgjegjësinë e çdo individit që të përdorë hapat e verifikimit të informacionit sa herë që ndeshet me të.

Vlerësimi i nxënësit bëhet duke u bazuar në shkallën e përmbushjes së rezultateve të pritshme të të mësuarit.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore, për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 70 pikë				
Përshkruesit	Niveli 1 - Dobët	Niveli 2 – Mjaftueshëm	Niveli 3 – Mirë	Niveli 4 – Shumë mirë
Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mëimit në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësit	0 – 1 pikë Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësit (RN) nuk bazohen në programin lëndor	2 – 3 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësi, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e	4 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodat	5 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së

	<i>dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i>	<i>rezultateve të të nxënit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënit dhe me stilet e të nxënit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore	0 – 1 pikë <i>Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	4 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore,</i>	5 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të</i>

			<i>duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>	<i>planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i>
Mjedisi i të nxënit (14 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me</i>

iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes	<i>përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
---	--	---	---	--

Metodat mësimore (21 pikë)

Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të nxënësve	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënësve. Ora e mësimit është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënësve të tij por ora e mësimit është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënësve.</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënësve të tij por metodat e teknikave që përdor në orën e mësimit nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që i njeh shumë mirë stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh me stilet e të nxënësve duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>
Mësuesi përdor metoda që	<i>0 – 1 pikë</i>	<i>2 – 3 pikë</i>	<i>4 - 5 pikë</i>	<i>6 - 7 pikë</i>

nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin)	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehjet e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehjet e mendimit kritik.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi	<i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet</i>	<i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha</i>	<i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë</i>	<i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit</i>

	<i>i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i>	<i>nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>
--	---	---	--	--

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi,	0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor</i>

vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes	<i>vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	<i>vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	<i>teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>	<i>teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të orës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të nxënësve të orës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetëm mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të orës mësimore.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të orës mësimore.</i>

	<i>nxënit të temës mësimore.</i>	<i>rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>nxënit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>


PROJEKTI KURRIKULAR

Roli i projektit kurrikular në fushën e të mësuarit

Projekti kurrikular është një instrument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për edukimin e aftësive për jetën dhe për të filluar, që në bankat e shkollës, procesin e krijimit të modeleve të ndryshme (të algoritmeve) të menduarit dhe të bërit të gjërave, pra të modeleve të vendimmarrjes, të zgjidhjes së konflikteve, të zgjidhjes së problemeve, të të mësuarit përmes kërkimit, të trajtimit të çështjeve kundërshtuese, etj.

Disa nga aftësitë intelektuale që edukohen përmes projektit janë:

- Aftësia për të kërkuar informacion – aftësia për të mësuar përmes kërkimit;
- Aftësitë e kërkimit dhe të mësuarit të pavarur;
- Aftësia për të dyshuar në vërtetësinë e informacionit;
- Aftësia për të dyshuar në burimin e informacionit;
- Aftësia për të kërkuar burime e para të informacionit;
- Aftësia për të kërkuar e për të mbledhur të dhëna;
- Aftësia për të përpunuar të dhënat;
- Aftësia për të interpretuar të dhënat;
- Aftësia për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në të dhënat e mbledhura;
- Aftësia për t'i përdorur të dhënat në funksion të mbrojtjes së një argumenti ose qëndrimi;
- Aftësia për të analizuar, për të krahasuar;
- Aftësia për të sintetizuar;
- Aftësia për të lidhur shkakun dhe pasojën;
- Aftësia për të zgjedhur e mbrojtur një qëndrim;
- Aftësia për të marrë vendime të mirinformuara;
- Aftësia për të komunikuar një vendim, një qëndrim etj.;
- Aftësia për të punuar në grup;
- Aftësia për të bërë kompromise;
- Aftësia për të pranuar këndvështrimet e ndryshme;
- Aftësia për të trajtuar çështjet kundërshtuese;
- Aftësia për të ndryshuar qëndrimin, pikëpamjen, këndvështrimin nëse këto e kërkojnë të dhënat, faktet etj..



Projektet kurrikulare mundësojnë procesin e ndërtimit të kompetencave për jetën pasi, duke i vendosur nxënësit në kontakt me sfidat dhe probleme reale të jetës, i mundësojnë atyre të ushtrohen në përdorimin e njohurive dhe të aftësive për t'i zgjidhur këto probleme. Në të njëjtën kohë, ky ushtrim do të lehtësojë edhe procesin e formimit të modeleve (algoritmeve) të të bërit të gjërave, pra të kompetencave për jetën.

Cilat janë disa nga pikënisjet pedagogjike që lidhen me projektin?

- Qëllimi kryesor i përfshirjes së nxënësve në projekt është të mësoarit për kompetencë.
- Projekti kurrikular zbatohet në kuadrin e përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të kurrikulës.
- Projekti kurrikular duhet t'iu mundësojë nxënësve jo vetëm përvetësimin e njohurive dhe të aftësive të nevojshme për ndërtimin e kompetencave për jetën, por edhe demonstrimin e shkallës së përvetësimit të tyre.
- Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të demonstruara gjatë hapave të projektit duhet të jetë objektiv i vazhdueshëm i mësuesit.
- Projekti kurrikular fillon mbi bazën e njohurive dhe aftësive paraprake të nxënësve dhe synon zhvillimin e tyre.
- Projekti kurrikular mund të shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor.
- Gjatë planifikimit të projektit, mësuesi duhet të ketë të qartë që në fillim qëllimin, rezultatet e pritshme të të mësoarit, strategjitë e përmbushjes së tyre si dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësve.
- Qëllimi, objektivat, pritshmëritë, strategjia, kriteret e vlerësimit duhet të jenë të qarta që në fillim për nxënësit dhe prindit.

Hapat e projektit

Projekti synon të ndihmojë nxënësit të mësojnë se si të shprehin opinionet e tyre, si të vendosin se cili nivel i ndërhyrjes dhe cili organ, institucion etj. është më i përshtatshmi për trajtimin e problemit të identifikuar dhe si të ndikojnë ata në zgjidhjen e problemeve në nivele të ndryshme.

Kjo kërkon që nxënësit të punojnë së bashku dhe, me ndihmën e mësuesit, të përmbushin detyrat që vijojnë:

- 1. Identifikimi i një problemi për të studiuar.** Nxënësit do të fillojnë duke identifikuar një problem në bashkësinë që mendojnë se është i rëndësishëm dhe të përcaktojnë se cili nivel i qeverisë është më drejtpërdrejt përgjegjës për trajtimin e problemit.
- 2. Mbledhja e informacionit.** Kur klasa të ketë vendosur për problemin që do të studiojnë nxënësit do të mbledhin dhe do të vlerësojnë informacionin për problemin nga një shumëllojshmëri burimesh.
- 3. Shqyrtimi i zgjidhjeve të mundshme.** Në këtë hap nxënësit do të shqyrtojnë politikat publike që përdoren nga qeveria, si dhe politikat që sugjerohen nga njerëz të tjerë.
- 4. Zhvillimi i politikës publike.** Nxënësit duhet të zhvillojnë politikën publike që mendoni se duhet të miratojë qeveria juaj.
- 5. Zhvillimi i një plani veprimi.** Së fundi, nxënësit duhet të zhvillojnë një plan veprimi për të treguar se ata mund të ndikojnë që qeveria ose agjencia qeveritare përgjegjëse të miratojë politikën publike të propozuar prej tyre.


Vlerësimi i projektit kurrikular

Projekti kurrikular i shërben procesit të të mësuarit. Si i tillë ai ndërtohet mbi bazën e kërkesave të kurrikulës, për t'i shërbyer përmbushjes së synimeve dhe objektivave të shpallur në të.

Vlerësimi i nxënësve që zbatojnë një projekt bëhet mbi bazën e arritjes ose të përmbushjes së objektivave të planifikuar në fushën e njohurive dhe të aftësive, të cilat nxënësit i demonstrojnë gjatë fazave të ndryshme të projektit.

Aftësitë e pritshme janë:

- Aftësia për të kërkuar informacion – aftësia për të mësuar përmes kërkimit;
- Aftësitë e kërkimit dhe të mësuarit të pavarur;
- Aftësia për të dyshuar në vërtetësinë e informacionit;
- Aftësia për të dyshuar në burimin e informacionit;
- Aftësia për të kërkuar burime e para të informacionit;
- Aftësia për të kërkuar e për të mbledhur të dhëna;
- Aftësia për të përpunuar të dhënat;

- 
- Aftësia për të interpretuar të dhënat;
 - Aftësia për të nxjerrë përfundime duke u bazuar në të dhënat e mbledhura;
 - Aftësia për t'i përdorur të dhënat në funksion të mbrojtjes së një argumenti ose qëndrimi;
 - Aftësia për të analizuar, për të krahasuar;
 - Aftësia për të sintetizuar;
 - Aftësia për të lidhur shkakun dhe pasojën;
 - Aftësia për të zgjedhur e mbrojtur një qëndrim;
 - Aftësia për të marrë vendime të mirinformuara;
 - Aftësia për të komunikuar një vendim, një qëndrim etj.;
 - Aftësia për të punuar në grup;
 - Aftësia për të bërë kompromise;;
 - Aftësia për të pranuar këndvështrimet e ndryshme;
 - Aftësia për të trajtuar çështjet kundërshtuese;
 - Aftësia për të ndryshuar qëndrimin, pikëpamjen, këndvështrimin nëse këtë e kërkojnë të dhënat, faktet etj..

Sigurisht, i takon mësuesit të dallojë nivelet e ndryshme të performancës së nxënësve në këtë projekt. Për ta lehtësuar këtë proces është vendosur që projekti të vlerësohet vetëm në fund të tij, gjë që i jep mundësinë çdo nxënësi të shprehë nivelin e tij të arritjes, bazuar në nivelet e miratuara të arritjeve.

TEMA: PROJEKTI QYTETAR

HYRJJE

Si mund të marrin pjesë qytetarët në zgjidhjen e problemeve të bashkësisë?

Politika publike është një mënyrë e rënë dakord që qeveria qendrore dhe ajo vendore të përmbushin përgjegjësitë e tyre, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të individëve dhe rritja e mirëqenies së të gjithë njerëzve. Disa politika publike shkruhen në ligje nga legjislaturat. Politika të tjera përmbahen në rregullat dhe rregulloret e krijuara nga degët ekzekutive të qeverisë dhe në degët përgjegjëse për zbatimin e ligjeve.

Këto që vijnë janë shembuj të politikave publike dhe të agjencive përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Qarqet e shkollave janë përgjegjëse për bërjen e politikave në lidhje me sjelljen dhe disiplinën e nxënësve. Mësuesit dhe administratorët e shkollave mundësojnë zbatimin e këtyre politikave


Legjislaturat e shtetit janë përgjegjëse, për bërjen e ligjeve që vendosin kufij shpejtësie për drejtuesit e automjeteve. Oficerët e policisë sigurojnë zbatimin e këtyre ligjeve

Qeveritë e qyteteve shpesh miratojnë politika që ndalojnë njerëzit të ngrenë dyqane të pijeve alkoolike pranë shkollave publike. Inspektorët e qytetit dhe ata rajonalë sigurojnë zbatimin e politikave të tilla.

Kur njerëzit vihen në dijeni të problemeve në bashkësinë e tyre, ata shpesh duan që qeveria të zhvillojë dhe zbatojë politika për t'i trajtuar këto probleme. Këto probleme mund të lidhen me:

- politika ose ligje ekzistuese që nuk funksionojnë mirë,
- politika ose ligje ekzistuese që nuk imponohen,
- mungesën e politikave ose të ligjeve.

Një qytetar, ka të drejtën të thotë mendimin e tij për atë që duhet të bëjë qeveria për zgjidhjen e problemeve në bashkësi. Ju keni gjithashtu të drejtën të thoni atë që mendoni për problemet në shtetin tuaj, në kombin dhe rreth problemeve ndërkombëtare. Ju keni të drejtën të përpiqeni të ndikoni në vendimet e qeveritarëve tuaj për të gjitha këto probleme.




Megjithatë, për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në zgjidhjen e problemeve të tyre, qytetarët kanë nevojë të dinë se cilat nivele të qeverisë dhe cilat agjenci qeveritare janë përgjegjëse për ndryshimin, për zbatimin dhe për zhvillimin e një politike të veçantë publike. Qeveritë vendore mund të krijojnë politika që të zbatojnë përgjegjësitë e tyre nëpërmjet ligjeve të miratuara në nivel qendror ose në nivel vendor. Përveç kësaj, si pjesë e procesit të zhvillimit dhe të zbatimit të politikës, agjencitë qeveritare duhet të vendosin në se politika e re bie ndesh me legjislacionin ose politikën ekzistuese.

Ky projekt synon t'ju ndihmojë nxënësit të mësojnë se si të shprehin opinionet e tyre, si të vendosin se cili nivel i qeverisë dhe cila agjenci është më e përshtatshme për trajtimin e problemit të identifikuar dhe si të ndikojnë në vendimet e politikës në nivelin e qeverisë. Kjo kërkon që nxënësit të punojnë së bashku dhe, me ndihmën e mësuesit, dhe të vullnetarëve të rritur, të përmbushin detyrat që vijnë:

- 6. Të identifikojnë një problem për të studiuar.** Nxënësit do të fillojnë duke identifikuar një problem në bashkësinë që mendojnë se është i rëndësishëm dhe të përcaktojnë se cili nivel i qeverisë është më drejtpërdrejt përgjegjës për trajtimin e problemit.
- 7. Të mbledhin informacion.** Kur klasa të ketë vendosur për problemin që do të studiojnë nxënësit, do të mbledhin dhe do të vlerësojnë informacionin për problemin nga një shumëllojshmëri burimesh.
- 8. Të shqyrtojnë zgjidhjet.** Në këtë hap nxënësit do të shqyrtojnë politikat publike që përdoren nga qeveria, si dhe politikat që sugjerohen nga njerëz të tjerë.
- 9. Të zhvillojnë politikën publike.** Ata duhet të zhvillojnë politikën publike që mendojnë se duhet të miratojë qeveria.
- 10. Të zhvillojnë një plan veprimi.** Së fundi, duhet të zhvillojnë një plan veprimi për të treguar se ata mund të ndikojnë që qeveria ose agjencia qeveritare përgjegjëse të miratojë politikën publike të propozuar prej tyre.

Ndërsa përmbushen këto detyra, klasa juaj do të përdorë materialet e mbledhura dhe të shkruara për të zhvilluar një **portofol** të klasës. Portofoli është një koleksion i organizuar informacioni që përbën planin e klasës suaj, lidhur me një çështje të politikës publike, që ju dhe klasa juaj keni vendosur të studioni.



Portofoli i klasës do të përmbajë gjëra të tilla si: thënie të shkruara, tabela, grafikë, fotografi dhe ilustrime origjinale. Këto materiale do të përshkruajnë:

- 1) atë që nxënësit kanë mësuar për problemin e përzgjedhur;
- 2) atë që nxënësit kanë për zgjidhjet alternative të problemit;
- 3) politikën publike të përzgjedhur ose të zhvilluar për të trajtuar problemin;
- 4) planin e veprimit që nxënësit kanë zhvilluar për ta bërë qeverinë të pranojë dhe miratojë politikën e sugjeruar.

Ky udhëzues do të ofrojë udhëzime hap-pas-hapi për identifikimin dhe studimin e një problemi politik e publik dhe për zhvilluar portofolin e klasës nga nxënësit.

Klasa mund t'ua paraqesë portofolin gojarisht, klasave të tjera në shkollë ose grupeve të bashkësisë. Ajo mund të fusë portofolin e saj në një konkurs me klasat e tjera që kanë zhvilluar gjithashtu portofola të tilla.

Njohuritë që do të fitojnë në studimin e një problemi në bashkësinë e tyre janë me shumë vlerë. Ato duhen ndarë me të tjerët për përfitim të ndërsjellë. Ndarja e njohurive dhe të kuptuarit të nxënësve do të ketë dobi edhe për ju. Ato do t'i ndihmojnë ata zhvillojnë aftësi të rëndësishme për pjesëmarrjen në një shoqëri vetëqeverisëse.

Në vijim udhëzuesi do të zhvillohet si një dialog të cilin mësuesi e zhvillon me nxënësit.



Hapi I

Identifikimi i problemeve të politikës publike në bashkësinë tuaj

Qëllimi

Në këtë hap ju do të lexoni një listë të shkurtër të problemeve të gjetura në shumë bashkësi në Shtetet e Bashkuara. Këto janë probleme që njerëzit shpesh mendojnë se duhet të trajtohen nga qeveria e tyre. Pas leximit të listës, ju:

do t'i tregoni klasës suaj atë që tashmë dini për këto probleme ose atë që ju keni dëgjuar në diskutimet rreth tyre;

do të intervistoni prindërit tuaj dhe të tjerët në bashkësinë tuaj, për të mësuar dhe për të regjistruar atë që ata dinë rreth këtyre problemeve dhe qëndrimet e tyre ndaj tyre.

Qëllimi i këtij hapi është që ju të ndani atë që ju, shokët e klasës dhe të tjerët dine tashmë rreth problemeve në bashkësinë tuaj. Kjo duhet ta ndihmojë klasën tuaj të fitojë informacionin e duhur për të bërë një zgjedhje të mençur të një problemi të veçantë për të studiuar.

1. Diskutim klase

Rreth asaj që dini për problemet në bashkësinë tuaj

Për të plotësuar këtë veprimtari e tërë klasa duhet :


të lexojë dhe të diskutojë për problemet e renditura që mund të gjenden në bashkësinë tuaj;

të ndahet në grupe prej dy ose tre nxënësish. Secili grup duhet të diskutojë për një prej problemeve dhe të shkruajë përgjigjet e tij ndaj pyetjeve rreth problemit, që renditen në Formularin e Identifikimit dhe të Analizës së Problemit

të ndajë përgjigjet e secilit grup me tërë klasën;

t'i mbajë formularët e plotësuar të të gjitha grupeve për përdorim të mëtejshëm.

Probleme të përbashkëta në bashkësitë



Bashkësitë nëpër Shtetet e Bashkuara kanë shumë probleme të përbashkëta. Disa probleme mund të jenë më serioze në disa bashkësi se sa në të tjerat. Njerëzit shpesh mendojnë se qeveria duhet të jetë përgjegjëse për miratimin e politikave për të ndihmuar zgjidhjen e këtyre problemeve.

Problemet në shkollë

1. Shumë njerëz shpallin se shkollat nuk mësojnë aftësi që i përgatisin nxënësit siç duhet për të gjetur punë pasi të diplomohen.
2. Disa nxënës përdorin një gjuhë dhe forma të shprehuri që ofendojnë grupe të tjera.
3. Veprimtaria e bandave si brenda ashtu edhe jashtë shkollës, frikëson shumë nxënës për sigurinë e tyre personale.

Problemet në lidhje me të rinjtë

1. Të rinjtë ndonjëherë punojnë me orë të zgjatura pas shkolle ose në fundjavë. Shpesh kjo e bën të vështirë që ata të ecin mirë në shkollë.
2. Disa prindër punëtorë nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar fëmijët gjatë kohës që ata janë në punë. Si rezultat fëmijët e vegjël mund të lihen vetëm në shtëpi, nganjëherë në rrethana të rrezikshme.


Problemet që lidhen me standardet e bashkësisë

1. Disa dyqane reklamojnë dhe shesin duhan dhe alkool pranë shkollave. Po kështu të tjerë shesin pranë mjediseve shkollore materiale që për disa janë të pahijshme.
2. Disa mjedise ose grupe shtëpish për pleqtë ose persona invalidë nuk i përmbushin standardet e shëndetit ose të sigurisë. Disa mund t'i trajtojnë banuesit e tyre në mënyrë të mjerueshme.

Problemet që përfshijnë liritë bazë

1. Një numër i madh njerëzish nuk votojnë në zgjedhje, veçanërisht në zgjedhjet lokale.
2. Shumë njerëz argumentojnë se paratë luajnë një rol tepër të madh në zgjedhjet e zyrtarëve të qeverisë.

Problemet që lidhen me mjedisin

- 
1. Disa bashkësi kanë probleme që përfshijnë konflikte rreth mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së punëve.
 2. Disa bashkësi nuk kanë programe riciklimi ose, ato që ato kanë, nuk punojnë mirë.

2. Veprimtaria me grupe të vogla

Diskutoni me një ose dy nxënës të tjerë për problemin që ju është caktuar.

Pastaj shkruani përgjigjet tuaja në Formularin e Identifikimit dhe të Analizës së Problemit.

Në qoftë se klasa juaj dëshiron të shqyrtojë për një problem të ri ajo është e lirë ta bëjë një gjë të tillë.

a. FORMULARI I IDENTIFIKIMIT DHE I ANALIZËS SË PROBLEMIT

Emrat e anëtareve të grupit _____

Data _____

Problemi _____

1. A mendoni ju dhe njerëzit e tjerë në bashkësi se ky është një problem i rëndësishëm?

2. Cili nivel qeveritar ose agjenci qeveritare është përgjegjës për trajtimin e problemit?


3. Cila është politika ekzistuese që lidhet me këtë problem?

1. Nëse ekziston një politikë lidhur me problemin në fjalë atëherë përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e politikës ekzistuese?

- Si mund të përmirësohet ajo?

- A është e nevojshme që kjo politikë të zëvendësohet me një politikë tjetër? Pse?

- 
-
-
- Cilat janë mosmarrëveshjet që ekzistojnë (nëse po) në bashkësinë tuaj?

-
-
4. Ku mund të sigurojmë informacion më të plotë për problemin e identifikuar dhe për qëndrimet e individëve dhe grupeve të ndryshme lidhur me të?

-
-
5. A mendoni se ekzistojnë në bashkësinë tuaj probleme të tjera që mund të shërbejnë për studimin tuaj? Cilët janë ato?

b. DETYRË SHTËPIE

Zbuloni më shumë rreth problemeve në bashkësinë tuaj

Tri detyrat që vijojnë duhet t'ju ndihmojnë që të mësoni më shumë për problemet në bashkësinë tuaj dhe për politikat publike të projektuara për t'i trajtuar ato. Përdorni formularët për të regjistruar informacionin që grumbulloni gjatë detyrave. Ju mund të doni të përfshini diçka prej tij në portofolin e klasës suaj.

- 1. Detyra e intervistës.** Përzgjidhni **një** problem nga sugjerimet në e mësipërme ose një problem të identifikuar nga klasa juaj, për ta diskutuar me familjen tuaj. Zbuloni se çfarë dinë dhe cili është mendimi i tyre për të. Përdorni Formularin e Intervistës (Faqe 8) për të regjistruar informacionin që ju merrni.
- 2. Detyra e burimeve të shkruara.** Në median e shkruar kërkon dëshmi rreth problemit ose rreth politikave të hartuara për ta trajtuar atë në bashkësinë tuaj. Sillni materialet që gjeni në klasën tuaj dhe ndajini ato me mësuesin dhe shokët e klasës suaj. Përdorni Formularin e Burimeve të shkruara (Faqe 9), për të regjistruar informacionin e shtypur të cilin keni shikuar.
- 3. Detyra e radios dhe e TV.** Ndiqui me kujdes në radio ose TV ato reportazhe ose lajme që kanë lidhje me problemin dhe politikat që lidhen me të. Silleni informacionin në klasë për ta ndarë me mësuesin dhe shokët e tjerë të klasës. Përdorni Formularin e Vrojtimit në Radio ose Televizion (Faqe 10), për të regjistruar informacionin që keni grumbulluar.

c. FORMULARI I INTERVISTËS

Emri juaj _____

Data _____

Problemi _____

1. Emri i personit të intervistuar _____

Shënim: Nëse ndonjëri nga personat e intervistuar nuk dëshiron t'i përmendet emri, respektoni të drejtën e tij të fshehtësisë dhe tregoni vetëm rolin e personit në bashkësi (për shembull: biznesmen, pensionist, prind, nxënës, vullnetar në bashkësi).

2. I bëni të njohur personit të intervistuar problemin që po studioni. Më pas bëni pyetjet e mëposhtme. Regjistroni përgjigjet.


a. A mendoni se problemi në fjalë është i rëndësishëm? Pse?

b. A mendoni se edhe anëtarët e tjerët të bashkësisë tuaj mendojnë se problemi është i rëndësishëm? Pse?

c. Cila është politika ekzistuese që lidhet me këtë problem?

d. Nëse ekziston një politikë e lidhur me problemin në fjalë atëherë përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e politikës ekzistuese?

- 
-
-
- Si mund të përmirësohet ajo?
-
-

A është e nevojshme që kjo politikë të zëvendësohet me një politikë tjetër? Pse?

- Cilat janë mosmarrëveshjet që ekzistojnë (nëse po) në bashkësinë tuaj?
-
-

d. Ku mund të sigurojmë informacion më të plotë për problemin e identifikuar dhe për qëndrimet e individëve dhe grupeve të ndryshme lidhur me të?

d. FORMULARI I BURIMEVE TË SHKRUARA

Emri juaj _____

Data _____

Problemi _____

Emri /Data e botimit _____

Nëntitujt e artikullit _____

1. Qëndrimet lidhur me problemin të shprehura në artikull:

2. Pikat kryesore të qëndrimeve rreth problemit:

3. Sipas burimit të shkruar, cila është politika ekzistuese e qeverisë për trajtimin e problemit:

4. Nëse ekziston një politikë lidhur me problemin në fjalë, atëherë, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë avantazhet e politikës ekzistuese?

- Cilat disavantazhet e politikës ekzistuese?

- 
- Si mund të përmirësohet ajo?

- A është e nevojshme që kjo politikë të zëvendësohet më një politikë tjetër? Pse?

- Cilat janë mosmarrëveshjet që ekzistojnë (nëse po) në bashkësinë tuaj?

e. FORMULARI I VËZHGIMIT TË RADIO/TELEVIZIONIT

Emri juaj _____

Data _____

Ora _____

Problemi _____

1. Burimet e informacionit:

(Këto mund të jenë: një programe informacioni të radios ose televizionit, dokumentarë, intervista ose programe të tjerë që lidhen me problemin.).


Gjatë kohës që shikoni ose dëgjoni programin në radio ose në televizion mbani parasysh çështjet e mëposhtme:

2. A mendohet që problemi në fjalë është i rëndësishëm? Pse?

3. Cila është politika ekzistuese e qeverisë lidhur me problemin e identifikuar?

▪ Cilat janë avantazhet e politikës ekzistuese?

▪ Cilat disavantazhet e politikës ekzistuese?



- Si mund të përmirësohet ajo?

- A është e nevojshme që kjo politikë të zëvendësohet me një politikë tjetër? Pse?

- Cilat janë mosmarrëveshjet që ekzistojnë në bashkësinë tuaj lidhur me problemin?





Hapi 2

Përzgjedhja e një problemi për studim klase

Qëllimi

Është që ju të keni mundësinë të diskutoni për problemet në bashkësinë dhe të merrni vendim nëse informacioni që keni është i mjaftueshëm për të përzgjedhur një problem për studim klase.

f. DISKUTIM NË KLASË

Vendosni nëse keni informacion të mjaftueshëm për të përzgjedhur një problem

Përdorni hapat që vijojnë për të përzgjedhur një problem të veçantë, që ta studiojë klasa juaj.

1. Në qoftë se klasa juaj mendon se ka mjaft informacion për të marrë një vendim, ajo duhet të përzgjedhë një problem me shumicë votash. Sigurohuni të përzgjidhni një problem që është i rëndësishëm për ju dhe bashkësinë tuaj. Sigurohuni që ai është një problem për të cilin ju mund të mblidhni informacionin e duhur për të zhvilluar një portofol.
2. Në qoftë se klasa vendos se informacioni për marrjen e vendimit lidhur me çështjen në studim nuk është i mjaftueshëm, atëherë grupeve u jepet detyra e shtëpisë për të grumbulluar më shumë informacion .



Hapi 3

Mbledhja e informacionit për çështjen që do të studiohet nga klasa juaj

Qëllimi

Tani që klasa juaj ka përzgjedhur çështjen e studimit, ju duhet të vendosni se ku do ta merrni informacionin shtesë që lidhet me të, pasi ju e dini se disa burime informacioni janë më të mira se të tjerat. Për shembull, në qoftë se ju keni përzgjedhur një problem që lidhet me mjedisin për të marrë informacionin e duhur, ju do t'iu drejtoheni atyre individëve ose grupeve të bashkësisë tuaj që dinë më shumë për këtë problem se të tjerët.

1. DISKTUTIM NË KLASË

Identifikimi i burimeve të informacionit

Kjo që vijon është një listë e disa burimeve të informacionit që ju mund të eksploroni. Lexoni dhe diskutoni listën. Vendosni se cilat prej burimeve duhet të shfrytëzoni. Pastaj ndahuni në **grupe kërkimore**.

Secili **grup kërkimor** duhet të mbledhë informacion nga një prej burimeve të renditura ose prej burimeve të tjera që ju do të identifikoni gjatë punës. Formularët që do t'ju ndihmojnë për mbledhjen dhe regjistrimin e informacionit ndodhen në faqet 8-10 dhe 17-20.


Vullnetarë të rritur mund ta ndihmojnë grupin tuaj në grumbullimin e informacionit, por ata nuk duhet ta bëjnë punën për ju. Ruajeni të gjithë informacionin që mblidhni për zhvillimin e portofolit të klasës.

Ju mund të keni dëshirë të ftoni edhe njerëz të tjerë për ta vizituar klasën tuaj për të ndarë atë që ata dinë për problemin në studim.

Shembuj burimesh informacioni

1. Bibliotekat

Bibliotekat e shkollës, bibliotekat publike, të kolegjit ose të universitetit në bashkësinë tuaj kanë gazeta dhe botime të tjera me informacion për çështjen për të cilën ju po bëni kërkime.



Bibliotekarët janë aty për t'ju ndihmuar të gjeni informacionin që keni nevojë. Bibliotekat mund të jenë të pajisura edhe me fotokopjuese të cilat ju mund t'i përdorni, të kenë makina që punojnë me monedha për bërjen e fotokopjeve të informacionit që ju mund të dëshironi të përdorni në portofolin tuaj.

2. Zyrat e gazetave

Ju mund të dëshironi të kontaktoni redaksi gazetash në bashkësinë tuaj. Reporterët e gazetave grumbullojnë informacion për problemet në bashkësitë e tyre dhe atë që qeveria po bën për to. Zyrat dhe reporterët e gazetave mund të jenë në gjendje të furnizojnë klasën tuaj me copa të prera gazetash për problemin që po studioni. Ata mund të sigurojnë gjithashtu fotografi kundrejt një pagesë të vogël.

3. Profesorët dhe studiuesit

Profesorët në kolegjet ose në universitetet lokale, mund të jenë ekspertë për çështjen që ju po studioni. Libri i telefonave përmban listën e zyrave të informacionit publik të kolegjeve ose të universiteteve aty pranë. Ju mund t'i telefononi këtyre zyrave për të gjetur vendin e studiuesve që mund të ishin të dobishëm. Ju mund të kontaktonit edhe mësues të shkollave të mesme në bashkësinë tuaj.

4. Juristët ose gjykatësit

Shumica e avokatëve dhe e gjykatësve u përkasin shoqatave të avokatëve që sigurojnë disa shërbime falas për publikun. Si avokatët ashtu edhe gjykatësit, janë burime të mira informacioni për shumë probleme në bashkësitë. Pyeteni drejtorin në se ka prindër të nxënësve në shkollën tuaj të cilët janë juristë. Përdorni një librin e telefonave për të gjetur shoqatën e avokatëve më pranë jush.

5. Organizatat e bashkësisë dhe grupet e interesit

Shumë grupe interesohen për probleme të bashkësisë ose të kombit. Këto quhen **grupe interesi**. Disa prej tyre mund të gjenden në bashkësinë ose zonën tuaj.

Përdorni një libër telefonik për të gjetur zyrat e tyre. Klasa juaj mund të ketë identifikuar disa grupe interesi që merren me problemin që po studioni kur bëtë detyrën e parë të shtëpisë.



Mësuesi juaj ose një vullnetar i rritur mund t'ju ndihmojë t'u telefononi ose t'u shkruani atyre, për informacion që kërkonit prej tyre.

6. Zyrat legjislative

Përfaqësuesit tuaj në degët legjislative ose ligjvënëse të qeverisë qendrore dhe vendore janë përgjegjës për identifikimin e problemeve dhe për sugjerimin ose mbështetjen e politikave publike për t'i trajtuar ato.

Anëtari juaj i kuvendit dhe përfaqësuesi juaj në legjislaturën tuaj të shtetit kanë secili nga një zyrë në bashkësinë, në zonën ose në shtetin tuaj. Ju mund t'i gjeni adresën dhe numrat e telefonave të këtyre zyrave në një libër telefonash. Secila zyrë do të ketë një ose më shumë njerëz në stafin e saj, që është përgjegjës për të ndihmuar ju dhe qytetarët e tjerë, për të fituar informacionin rreth problemeve në bashkësinë, shtetin tuaj dhe kombin.

Anëtarët e kuvendit mund të jenë në gjendje të marrin informacione rreth problemit që ju po studioni.


7. Agjencitë administrative

Njerëzit që punojnë në agjencitë administrative të qeverisë suaj lokale, të shtetit dhe asaj kombëtare, mund të trajtojnë problemin që klasa juaj ka zgjedhur të studiojë. Zyrat e informacionit publik mund të sigurojnë informacion rreth problemit dhe atë që qeveria po bën për të. Për shembull, qeveria juaj lokale mund të ketë një sektor shëndetësor ose një sektor të sigurisë së ndërtimit. Përdorni librin tuaj të telefonave për t'i gjetur këto ose zyra të tjera të përshtatshme.

8. Rrjetet e informacionit elektronik

Shumë prej burimeve të mësipërme, si edhe shumë të tjera janë të disponueshme edhe nëpërmjet internetit. Në qoftë se shkolla juaj, nuk ka mundësi të përfitojë nga ky shërbim, kërkonit në bibliotekat në zonën tuaj.

2. UDHËZIME



Për fitimin dhe dokumentimin e informacionit

Shumica e njerëzve që punojnë në vendet ku ju mund të gjeni informacion, janë shumë të zënë me punë. Për këtë arsye, për të lehtësuar punën e klasës suaj në marrjen e informacionit të dëshiruar, është e rëndësishme të ndiqni sugjerimet në vijim:

1. Të vizituarit e bibliotekave dhe të vendeve të tjera ku mund të gjendet informacion.

Individualisht ose në grupe të vogla ju mund të vizitoni biblioteka ose zyra të grupeve të ndryshme publike ose private që kanë informacion për problemin. (Përdorni informacionin nga Formularët e dokumentimit të informacionit).

2. Marrja e burimeve në telefon.

Jo më shumë se **një** nxënës duhet t'i jepet detyra e marrjes në telefon të një zyre për informacion. Për këtë arsye, është e rëndësishme që nxënësi që merr në telefon, të regjistrojë qartë informacionin e fituar gjatë një interviste telefonike. (Përdorni Formularin e dokumentimit të informacionit të marrë nga letrat ose intervistat).

3. Bërja e takimeve dhe intervistimi i njerëzve.


Një nxënës duhet të telefonojë për të rregulluar një takim. Një grup i vogël mund të vizitojë një zyrë person për të zhvilluar një intervistë personale. (Përdorni Formularin e dokumentimit të informacionit të marrë nga letrat ose intervistat).

4. Të shkruarit dhe të kërkuarit e informacionit.

Një ose më shumë nxënës mund të shkruajnë një letër, duke kërkuar informacion nga çdo zyrë ose person. Përfshirja e një zarfi të stampuar të vet-adresuar mund t'ju ndihmojë të merrni një përgjigje. (Përdorni Formularët e dokumentimit të informacionit, për të regjistruar informacionin që ju merrni.)

3. DETYRË SHTËPIE

Kërkime për problemin në bashkësinë tuaj



Pasi vendos se çfarë burimesh informacioni të përdorë, klasa duhet të ndahet në grupe kërkimore. Secili grup duhet të jetë përgjegjës për mbledhjen e informacionit nga një burim i ndryshëm.

Në qoftë se në grupin tuaj kërkimor ju jeni personi të cilit i është dhënë detyrë të kontaktojë një prej burimeve të informacionit të përshkruara më sipër, filloni duke prezantuar veten tuaj. Pastaj informoni personin për qëllimin tuaj, ose përse keni kërkuar takim me të. Përdorni udhëzimet që vijojnë për prezantimin e vetes suaj nëpërmjet një letre ose personalisht.

((Përdorni Formularin e dokumentimit të informacionit të marrë nga letrat ose intervistat për të regjistruar informacionin që do të merrni).

Prezantimi i vetes

Unë quhem... (emri juaj).

Unë jam nxënës në klasën..... në shkollën..... me mësues.....

Ne po studiojmë probleme lokale, si trajtohen ato nga qeveria dhe se si qytetarët mund të marrin pjesë në qeverinë e tyre.

Problemi që po studion klasa ime është... (përshkruani shkurtimisht problemin).

Unë jam përgjegjës që informacionin që do të zbuloj rreth problemit, ta ndaj me klasën time.

A mund t'ju bëj disa pyetje tani ose a ka ndonjë kohë tjetër që do të ishte më e mirë që unë t'ju telefonoj? A ka ndonjë person tjetër që duhet t'i telefonoj?

A keni ndonjë informacion të shkruar rreth problemit që mund të na e dërgoni? (Në qoftë se po, telefononi dhe nëse përgjigja është po, përgatituni t'i jepni atij personi adresën e shkollës suaj.).

4. FORMULARI I DOKUMENTIMIT TË INFORMACIONIT

TË MARRË NGA BURIME TË SHKRUARA OSE ELEKTRONIKE

Emri i anëtarëve të grupit të kërkimit _____

Data _____

Problemi për të cilin është bërë kërkimi _____

Emri i bibliotekës, zyrës, agjencisë ose faqes së internetit të vizituar

1. Burimi i informacionit

Emri i botimit /faqes së internetit _____

Autori _____

Data e publikimit/faques së internetit _____

2. Informacioni i regjistruar nga botimi ose faqja e internetit që ju ndihmon t'u përgjigjeni sa më shumë prej pyetjeve të mëposhtme:

a. Sa i rëndësishëm është problemi për bashkësinë tuaj?

b. Sa i përhapur është ky problem në vendin tuaj?

c. Cila prej pohimeve të mëposhtme është i vërtetë?

- Nuk ekziston asnjë ligj ose politikë që trajton me problemin në fjalë

☐ PO ☐ JO

- Ligji ekzistues që trajton problemin nuk është i përshtatshëm ☐

PO ☐JO

- Ligji për trajtimin e problemit është i përshtatshëm por

nuk zbatohet si duhet

☐ PO ☐JO


- d. Cilat janë nivelet e qeverisë ose agjencitë qeveritare që janë përgjegjëse për trajtimin e problemit? Çfarë po bëjnë ato për ta zgjidhur atë?

- e. Cilat janë mosmarrëveshjet lidhur me politikën ose për rrugët e trajtimit të problemit që ekzistojnë në bashkësinë tuaj?

- f. Cilët janë individët, grupet ose organizatat kryesore që shprehën opinionin e tyre për problemin?

- g. Përse janë të interesuar për problemin?

- h. Cili është qëndrimi i tyre?



i. Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e qëndrimit të tyre?

j. Cila është përpjekja e tyre për të ndikuar tek qeveria që kjo të pranojë qëndrimin e tyre?

k. Në ç 'mënyrë unë dhe klasa ime mund të sigurojmë informacion më të plotë për qëndrimet e tyre?



FORMULARI I DOKUMENTIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË NGA LETRAT OSE INTERVISTAT

Emri i anëtarëve të grupit të kërkimit _____

Data _____

Problemi për të cilin është bërë kërkimi _____

1. Burimet e informacionit

a. Emri _____

b. Titulli ose organizata _____

c. Adresa _____

d. Telefoni _____

2. Kërkoni informacioni për problemin. Pasi të bëni të njohur veten tuaj me letër ose me telefon, kërkoni përgjigje për pyetjet e mëposhtme:

a. Sa i rëndësishëm është problemi për bashkësinë tuaj?

b. Sa i përhapur është ky problem në vendin tuaj?

c. Përse mendoni se ky problem duhet të zgjidhet nga qeveria? A ka të tjerë që duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për ta zgjidhur problemin? Pse?

d. Cila prej pohimeve të mëposhtme është i vërtetë?

- ☐ Nuk ekziston asnjë ligj ose politikë që trajton me problemin në fjalë

☐ PO ☐ JO

- Ligji ekzistues që trajton problemin nuk është i përshtatshëm ☐

PO ☐ JO ☐

- Ligji për trajtimin e problemit është i përshtatshëm por

nuk zbatohet si duhet


☐ PO ☐ JO

- e. Cilat janë nivelet e qeverisë ose agjencitë qeveritare që janë përgjegjëse për trajtimin e problemit? Çfarë po bëjnë ato për ta zgjidhur atë?

- f. Cilat janë mosmarrëveshjet lidhur me politikën për rrugët e trajtimit të problemit që ekzistojnë në bashkësinë tuaj?

- g. Cilët janë individët, grupet ose organizatat kryesore që shprehën opinionin e tyre për problemin?

- h. Përse janë të interesuar për problemin?



i. Cili është qëndrimi i tyre?

j. Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e qëndrimit të tyre?

- Në ç ‘mënyrë mund të sigurojmë informacion për qëndrimet e tyre?

k. Cila është përpjekja e tyre për të ndikuar tek qeveria që kjo të pranojë qëndrimin e tyre?

l. Nëse klasa jonë do të zhvillojë një politikë që synon të zgjidhë këtë problem, në ç ‘mënyrë ne do të mund të ndikonim tek qeveria për të miratuar politikën tonë?

Hapi 4

Zhvillimi i portofolit të klasës

Qëllimi

Ju tani duhet të keni kryer mjaft kërkime për të filluar të zhvilloni portofolin e klasës suaj. Në fillim, nxënësit e klasës suaj duhet të punojnë së bashku, për të diskutuar dhe për t'u përgjigjur pyetjeve që ndodhen në disa fletë pune. Në vijim, klasa juaj duhet të ndahet në katër grupe dhe secili grup do të jetë përgjegjës për zhvillimin e njëres prej pjesëve të portofolit.

Materialet në portofolat duhet të përfshijnë dokumentacionin më të mirë që klasa dhe grupi kanë mbledhur për shqyrtimin e çështjes ose të problemit. Ai duhet të përfshijë gjithashtu materialet dhe/ose punën origjinale të shkruar të nxënësve.

1. FLETËT E PUNËS

Arritja e një marrëveshjeje të përbashkët


Që të kuptoni si duhet atë që është e nevojshme për të përmbushur me sukses secilën nga katër detyrat e portofolit, ju duhet të punoni së bashku për të plotësuar fletët e mëposhtme. Kur klasa të gjykojë se i është përgjigjur mirë pyetjeve, mësuesi do t'ju caktojë njëren nga katër detyrat e portofolit ose do t'ju kërkojë të zgjidhni grupin që dëshironi.

Pasi të keni përfunduar diskutimin për fletët e punës, përdorini ato për të zhvilluar pjesën tuaj të portofolit. Ndërkohë që punoni për detyrën tuaj, ju nuk duhet të ndërprisni komunikimin me grupet e tjera për të ndarë informacionin dhe për të raportuar për përparimin e bërë.

2. DETYRA 1. SHPJEGIMI I PROBLEMIT

Qartësimi dhe shpjegimi i problemit të zgjedhur është hapi i parë që duhet të ndërmerreni së bashku me shokët e klasës. Ju duhet të shpjegoni pse ky problem është i rëndësishëm, cilat janë individët dhe grupet e bashkësisë tuaj që janë të interesuar për të dhe cila pjesë e qeverisë është përgjegjëse për trajtimin e tij. Për të realizuar këtë detyrë, ju duhet t'i përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme

1. Cili është problemi që klasa ka zgjedhur për të studiuar?




2. Sa serioz është ky problem për bashkësinë tuaj?

3. Sa i përhapur është problemi në bashkësinë tuaj?

4. Përse ky problem duhet të trajtohet nga qeveria?

5. A duhet të marrë edhe dikush tjetër përgjegjësinë për zgjidhjen e problemit?

6. A ka ndonjë ligj ose politikë për ta trajtuar problemin?



7. Nëse ekziston një ligj, a mendoni se ai është i ligji i duhur për të zgjidhur problemin?


8. Çfarë mosmarrëveshesh, në qoftë se ka, ekzistojnë në bashkësinë tuaj për këtë problem?

9. Cilët janë individët, grupet dhe organizatat madhore që tregohen të interesuar për problemin?

10. Për secilin nga individët, grupet ose organizatat e interesuara përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

Cili është qëndrimi i tyre?

Përse janë të interesuar ato?



Cilat janë avantazhet e qëndrimeve të tyre?

Cilat janë disavantazhet e qëndrimeve të tyre?

Si po përpiqen këto të ndikojnë në qeveri për të miratuar pikëpamjet e tyre?

11. Cilat nivele të qeverisë ose të agjencive qeveritare, në qoftë se ka, janë përgjegjëse për trajtimin e problemit?

12. Çfarë po bëjnë ato për problemin?

3. DETYRA 2 – SHQYRTIMI I POLITIKAVE ALTERNATIVE

Ju duhet të identifikoni disa politika alternative për trajtimin e problemit që keni zgjedhur për studim. Këto politika mund të jenë politika ekzistuese ose politika të propozuara nga individë ose grupe të bashkësisë suaj. Ju mund të përfshini edhe idetë tuaja origjinale për politikat që duhen për të trajtuar këtë problem.

Për secilën nga politikat e paraqitura ju duhet:

1. të shpallni politikën ose të sugjeroni politikën;
2. të identifikoni individët ose grupet që e kanë propozuar këtë politikë (kjo mund të jetë edhe politika e sugjeruar nga klasa ose grupi juaj);
3. të identifikoni avantazhet e politikës së propozuar;
4. të identifikoni disavantazhet e politikës së propozuar;
5. të identifikoni individët ose grupet e tjerë të bashkësisë suaj të cilët mendoni se mund të mbështesin këtë politikë;
6. të identifikoni individët ose grupet e tjerë të bashkësisë suaj të cilët mendoni se mund të kundërshtojnë këtë politikë.

Në vijim shkruani përgjigjet tuaja për secilën nga politikat e identifikuara.

4. DETYRA 3 – PROPOZIMI I NJË POLITIKE PUBLIKE

Në vijim ju duhet të propozoni një politikë publike që do të trajtojë problemin e zgjedhur. Kjo politikë nuk duhet të jetë në kundërshtim me kushtetutën e vendit tuaj. Kjo mund të jetë një ndër politikat alternative të diskutuara më parë, mund të jetë një rast i ndryshuar i njërës prej atyre politikave ose mund të jetë një nga idetë tuaja origjinale. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme dhe plotësoni edhe formularin e opinionit kushtetues që ndodhet në këtë libër.

1. Ne mendojmë se politika më e mirë publike për të trajtuar këtë problem është:

2. Avantazhet e kësaj politike janë:

3. Disavantazhet e kësaj politike janë:

4. Identifikoni nivelet e qeverisë që duhet të jenë përgjegjëse për realizimin e politikës së propozuar. Shpjegoni pse ky nivel i qeverisë është përgjegjës për këtë:

5. Politika e propozuar është në përputhje me kushtetutën sepse (përdorni formatin e opinionit kushtetues për të plotësuar këtë pikë):

5. DETYRA 4 – ZHVILLIMI I PLANIT TË VEPRIMT


Që politika juaj të miratohet nga niveli ose agjencia e duhur e qeverisë, ju duhet të zhvilloni një plan veprimi. Ky plan duhet të përmbajë hapat që ju do të ndërmerri që politika juaj të mbështetet nga një ligj dhe të zbatohet nga qeveria.

1. Veprimtaritë kryesore të planit tonë janë:

2. Individët ose grupet me pushtet që mund të mbështetin politikën propozuar:

3. Për të fituar mbështetjen e tyre ne duhet të:

4. Individët ose grupet me pushtet që mund të kundërshtojnë politikën e propozuar:



6. DETYRA 4 – ZHVILLIMI I PLANIT TË VEPRIMIT (vazhdim)


5. Ne mund të arrijmë të fitojmë mbështetje nga këta individë ose grupe duke:

6. Zyrtarë të pushtetshëm ose agjenci që mund të mbështetin politikën e propozuar:

7. Ne mund të sigurojmë mbështetjen e tyre duke:

8. Zyrtarë të pushtetshëm ose agjenci që mund të kundërshtojnë politikën e propozuar:

9. Ne mund të sigurojmë mbështetjen e tyre duke:



7. DETYRAT E GRUPEVE

Këto që vijojnë janë detyrat e secilit grup të portofolit. Nga materialet e grumbulluara nga puna kërkimore, grupet përzgjedhin ato që i ndihmojnë të plotësojnë detyrën e përshkruar më poshtë. (Udhëzime më të hollësishme për secilin grup përfshihen në faqen tjetër në pjesën D.)

Grupi I i portofolit:

Shpjegimi i problemit.

Ky grup është përgjegjës për shpjegimin e problemit që klasa ka zgjedhur për të studiuar. Grupi duhet të shpjegojë përse problemi është i rëndësishëm dhe përse një nivel i caktuar i qeverisë ose agjenci qeveritare duhet ta trajtojë atë.

Grupi II i portofolit:

Vlerësimi i politikave alternative të sugjeruara për të trajtuar problemin.

Ky grup është përgjegjës për shpjegimin e politikave ekzistuese dhe/ose e alternative të projektuara për të zgjidhur problemin.

Grupi III i portofolit:

Zhvillimi i politikës publike që klasa do të mbështesë.

Ky grup është përgjegjës për zhvillimin dhe justifikimin e një politike publike të veçantë, të cilën shumica e klasës pranon ta mbështesë.

Grupi IV i portofolit:

Zhvillimi i një plani veprimi për ta bërë qeverinë të pranojë politikën e klasës.

Ky grup është përgjegjës për zhvillimin e një plani veprimi që tregon se si qytetarët mund të **ndikojnë** në qeverinë e tyre për të miratuar politikën që mbështetet klasa.

8. KRITERET E VLERËSIMIT

Ka një “Listë kontrolli të kriterëve të portofolit” e cila do t’ju ndihmojë të zhvilloni portofolin më të mirë të mundshëm. Në të njëjtën kohë, ju duhet të shikoni edhe kërkesat e veçanta që duhen për pjesën e paraqitjes dhe të dokumentimit për secilën nga grupet e portofolit për t’u siguruar që keni përfshirë gjithçka që kërkohet nga ju. Këto kërkesa të veçanta ndodhen në pjesët në vijim. Përdoreni këtë informacion si një udhëzues gjatë kohës që jeni duke zhvilluar portofolin tuaj.

Përveç zërave të përshkruara në “Listën e kontrollit të kriterëve të portofolit”, ju do të duhet të shqyrtoni dhe informacionin e përgjithshëm që portofoli juaj do të ketë tek lexuesi. Për këtë qëllim është mirë që portofoli të dëshmojë si për zgjidhje krijuese të problemit ashtu edhe për originalitet. Kujdesuni që të jeni përzgjedhës të mirë të informacionit që paraqisni.

Në qoftë se klasa juaj e fut portofolin e saj në një konkurs me klasat e tjera, ai do të vlerësohet nga një juri gjykatësish e cila do ta vlerësojë atë duke mbajtur parasysh “Listën e kontrollit të kriterëve të portofolit”. Ata do t’u japin vlerësime si për portofolin në tërësi, ashtu dhe për pjesë të veçanta të tij.

9. UDHËZIME PËR GRUPET

Udhëzimet që vijojnë përcaktojnë detyrat e secilit grup në hollësi. Megjithëse grupet kanë detyra të veçanta, është e rëndësishme që ata të komunikojnë me njëri-tjetrin për të ndarë njohuritë dhe informacionin. Çdo grup duhet ta mbajë klasën të informuar për punën e bërë dhe të bashkëpunojë me grupet e tjera që e gjithë klasa të zhvillojë portofolin më të mirë të mundshëm.

Grupet duhet të bashkëpunojnë edhe për të vendosur për çështjet që duhet të përfshihen në pjesën e afishimit dhe atë të dokumentacionit të portofolit. Ky bashkëpunim do të shmangë afishimin e të njëjtit informacion më shumë se një herë dhe do të sigurojë përzgjedhjen e ekspozimeve ose të dëshmive më të mira.

10. HOLLËSIRA

Puna e të katër grupeve do të përmbledhet në një portofol të klasës, i cili do të ketë dy pjesë: pjesën e **afishimit** dhe pjesën e **dokumentacionit**.



1. Pjesa e afishimit.

Për këtë pjesë puna e secilit prej të katër grupeve duhet të vendoset në një panel të veçantë të afishimit katër-panelesh. **Afishimi duhet të përbëhet prej katër fletësh tabele poster, tabelë bukë-peshku, ose materiale të ngjashme me to, por jo më të mëdha se 80cm të gjerë me 100cm të lartë.** Afishimi duhet të zhvillohet në mënyrë që ai të mund të vendoset në një tryezë tabelë buletini ose një këmbalec.

Materialet për t'u afishuar mund të përfshijnë thënie të shkruara, listë burimesh, tabela, grafikë, fotografi dhe ilustrime origjinale, etj.

2. Pjesa e dokumentimit.

Secili prej të katër grupeve duhet të përzgjedhë nga materialet e mbledhura ato që **dokumentojnë** ose dëshmojnë më mirë për kërkimet e tyre. Materialet e përfshira në pjesën e dokumentimit duhet të jenë tregues kuptimplotë të kërkimeve më të rëndësishme që ju keni kryer. Jo i gjithë kërkimi duhet përfshirë në dokumentacion.

Materialet në dokumentacion duhet të vihen në një lidhës me tri unaza jo më të mëdha se 5cm të trashë. Përdorni ndarës me ngjyra të ndryshme për të ndarë të katër pjesët. Përgatitni një tabelë të përmbajtjes për secilën pjesë.



Grupi i portofolit: 1

SHPJEGIMI I PROBLEMIT

Grupi juaj është përgjegjës për shpjegimin e problemit në pjesët e para të afishimit dhe të dokumentacionit të portofolit të klasës suaj.

A. AFISHIMI I PORTOFOLIT: PJESA 1

Kjo pjesë duhet të përfshijë pikat që vijojnë:

1. Një përmbledhje me shkrim të problemit.

Rishikoni materialin e mbledhur nga grupet kërkimore. Shkruani jo më shumë se dy faqe të shtypura për të shpjeguar problemin. Përmbliidhni atë që keni mësuar, duke shfrytëzuar përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në fletën e punës me titull, Detyra 1 “Shpjegimi i problemit”.


2. Paraqitjet grafike të problemit

Këtu hyjnë harta, grafikë, fotografi, satira politike të animuara, tituj gazetash dhe ilustrime të tjera nga burime të shkruara ose nga krijimet tuaja origjinale.

Secili ilustrim duhet të ketë një krye ose titull.

3. Identifikimi i burimeve tuaja të informacionit.

Në një ose më shumë faqe të shkruara, identifikoni burimet që ka përdorur klasa.



B. DOKUMENTIMI I PORTOFOLIT: PJESA 1

Në pjesën e parë të dosjes së klasës përfshini kopje të **informacionit më të mirë ose më të rëndësishëm** që klasa juaj ka mbledhur dhe përdorur për shqyrtimin dhe shpjegimin e problemit. Për shembull, ju mund të përfshini:

pjesë gazetash ose revistash të përzgjedhura;

përmbledhje të shkruara të intervistave me njerëz të bashkësisë;

përmbledhje të përzgjedhura të trajtimit të problemit nga radioja ose/dhe televizioni;

komunikime të përzgjedhura nga grupe interesi publike dhe private;

pjesë nga botime qeveritare.

Dokumentet dhe përmbledhjet e gjata duhet të paraqiten nëpërmjet kopjeve të faqeve të tyre të titullit, tabelave të përmbajtjes dhe nëpërmjet një përmbledhjeje prej një faqeje të dokumentit, të marrë nga vetë dokumenti, ose të shkruar nga grupi. Sigurohuni të përgatisni një tabelë të përmbajtjes për këtë pjesë.



Grupi i portofolit: 2

SHQYRTIMI I POLITIKAVE ALTERNATIVE

Grupi juaj është përgjegjës për shpjegimin e qartë dhe për vlerësimin e politikave alternative të synuara për të trajtuar problemin. Zbulimet tuaja paraqiten në pjesët e dyta të afishimit dhe të dokumentimit të portofolit të klasës suaj.

A. AFISHIMI I PORTOFOLIT: PJESA 2

Kjo pjesë duhet të përfshijë pikat që vijojnë:

1. Një përmbledhje me shkrim të politikave alternative.

Përzgjidhni dy ose tri prej politikave të propozuara nga individë ose grupe të ndryshme. (Ju mund të përfshini një politikë ekzistuese). Për secilën politikë të përzgjedhur, përmbledhni në jo më shumë se një faqe të shkruar, përgjigjet e pyetjeve në fletën e punës me titull: Detyra 2 – “Shqyrtimi i politikave alternative”.

2. Paraqitjet grafike të politikave.

Kjo mund të përfshijë tabela, grafikë, fotografi, vizatime, karikatura politike, tituj gazetash, tabela statistikash dhe ilustrime të tjera të lidhura me politikën. Ilustrimet mund të jenë nga burime të shkruara ose ato mund të jenë krijimet tuaja origjinale. Secili ilustrim duhet të ketë një krye ose titull.

3. Identifikimi i burimeve tuaja të informacionit.

Në një ose më shumë faqe të shkruara, identifikoni burimet që klasa ka përdorur për të mbledhur informacione.



B. DOKUMENTIMI I PORTOFOLIT: PJESA 2

Në Pjesën 2 të dosjes së klasës, përfshini kopje të **informacionit më të mirë ose më të rëndësishëm** që klasa juaj mbledhi dhe përdori për shqyrtimin dhe shpjegimin e problemit. Për shembull, ju mund të përfshini si dokumentacion:

- pjesë gazetash ose revistash të përzgjedhura;
- raporte të shkruara të përzgjedhura intervistash me njerëz në bashkësinë;
- raporte të shkruara të përzgjedhura të mbulimit të problemit nga radioja dhe televizioni;
- komunikime të përzgjedhura nga grupe interesi publike dhe private;
- ekstrakte nga publikime qeveritare.

Dokumentet dhe raportet tepër të gjata duhet të paraqiten nëpërmjet kopjesh të faqeve të tyre të titullit, tabelat e përmbajtjes dhe një përmbledhje prej një faqe (ose abstrakt) të dokumentit, ose të marrë nga vetë dokumenti ose të shkruar nga grupi. Sigurohuni të përgatisni një tabelë të përmbajtjes për këtë pjesë.

Grupi i portofolit: 3

PROPOZIMI I NJË POLITIKE PUBLIKE PËR TË TRAJTUAR PROBLEMIN

Grupi juaj është përgjegjës për propozimin e një politike publike për të trajtuar problemin. Politika e zgjedhur nga grupi, duhet të pranohet nga shumica e klasës suaj. Ajo gjithashtu duhet të jetë një politikë që nuk dhunon kushtetutën. Formulari i Opinionit Kushtetues që gjendet në faqet 36-37, do t'ju ndihmojë ju dhe klasën tuaj për t'u siguruar që politika juaj nuk dhunon kushtetutën federale ose kushtetutën e shtetit tuaj. Sapo kjo të jetë vendosur, klasa juaj mund të zgjedhë:

- të mbështesë një prej politikave alternative të identifikuara nga Grupi 2 i portofolit;
- të përshtatë një prej atyre politikave;
- të zhvillojë politikën e saj vetjake.

A. AFISHIMI I PORTOFOLIT: PJESA 3

Kjo pjesë duhet të përfshijë pikat që vijnë:

1. Një shpjegim dhe justifikim me shkrim për politikën e sugjeruar nga klasa juaj.

Ju duhet të shpjegoni politikën që përzgjedh klasa juaj dhe arsyet për mbështetjen e saj, në jo më shumë se dy faqe të shkruara. Për të realizuar këtë detyrë shfrytëzoni fletën e punës me titull , Detyra 3 – “Propozimi i një politike”

2. Paraqitjet grafike të politikës propozuar.

Kjo mund të përfshijë tabela, grafikë, fotografi, vizatime, karikatura politike, tituj gazetash, tabela statistikash dhe ilustrime të tjera të lidhura me politikën dhe problemin që ajo synon të zgjidhë. Këto ilustrime mund të vijnë nga burimet e shkruara ose ato mund të jenë krijimet tuaja origjinale. Secili ilustrim duhet të ketë një krye ose titull.

3. Identifikimi i burimeve tuaja të informacionit.

Në një ose më shumë faqe të shkruara, identifikoni burimet që klasa ka përdorur për të mbledhur informacion.

B. SEKSIONI I DOKUMENTIMIT TË PORTOFOLIT: PJESA 3

Në Pjesën 3 të dosjes së klasës, përfshini kopje të **informacionit më të mirë ose më të rëndësishëm** të mbledhur dhe të përdorur nga klasa juaj për zhvillimin e politikës së propozuar. Për shembull, ju mund të përfshini si dokumentacion:

pjesë gazetash ose revistash të përzgjedhura;

raporte të përzgjedhura të intervistave me njerëz të bashkësisë;

raporte të përzgjedhura të radios dhe të televizionit për problemin në fjalë;

komunikime të përzgjedhura nga grupe interesi publike dhe private;

pjesë të shkëputura nga publikime qeveritare.

Dokumentet dhe raportet tepër të gjatë duhet të paraqiten nëpërmjet kopjeve të faqeve të tyre, të titullit, tabelave të përmbajtjes dhe të një përmbledhjeje prej një faqe të dokumentit të marrë nga vetë dokumenti, ose të shkruar nga grupi. Sigurohuni të përgatisni një tabelë të përmbajtjes për këtë pjesë.

FORMULARI I OPINIONIT KUSHTETUES

Kushtetuta dhe dokumentet themelore për të drejtat e njeriut, përcaktojnë atë që qeveria mund të bëjë për mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Sa herë që ne i sugjerojmë qeverisë të miratojë një ligj ose një politikë për trajtimin e një problemi, është e rëndësishme që asaj të mos i kërkohet të bëjë diçka që është e ndaluar nga kushtetuta. Çdo qytetar ka të drejtën dhe përgjegjësinë të gjykojë nëse një politikë ose një ligj i caktuar është në kundërshtim me kufizimet që kushtetuta i ka vënë qeverisë.


Lista e mëposhtme përmban disa nga kufizimet më të rëndësishme që kushtetuta vendos për qeveritë për të mbrojtur të drejtat tona. Përdoreni këtë listë për të zhvilluar politikën tuaj. Bëni kujdes që politika e sugjeruar nga ju të mos shkelë kufizimet e vendosura ndaj qeverisë.

Ky format duhet të mbahet parasysh nga e gjithë klasa. Këto rezultate duhet të përfshihen në Pjesën 3 të pjesëve të paraqitjes dhe të dokumentimit të portofolit tuaj.

Listë kontrolli

1. Qeveria nuk ka të drejtë të ndërhyjë në liritë dhe bindjet e personit. Politika e propozuar nga ne, i shkel/nuk i shkel kufizimet e vendosura ndaj pushtetit të qeverisë. Shpjegoni pse.

2. Qeveria nuk ka të drejtë të kufizojë në mënyrë të paarsyeshme dhe të padrejta të drejtat e personit për t'u shprehur me gojë, me shkrim ose me mjete të tjera. Politika e propozuar nga ne, i shkel/nuk i shkel kufizimet e pushtetit të qeverisë. Shpjegoni pse.


- 
3. Qeveria nuk ka të drejtë të drejtë të shkelë të drejtat dhe liritë e personit pa i dhënë atij mundësinë për t'u dëgjuar në një proces të rregullt gjyqësor ose përpara një agjencie të autorizuar qeveritare. Politika e propozuar nga ne, i shkel/nuk i shkel kufizimet e pushtetit të qeverisë. Shpjegoni pse.

4. Qeveria nuk ka të drejtë të dhunojë banesën private të një personi, pa një arsye të fortë për ta bërë këtë. Politika e propozuar nga ne, i shkel/nuk i shkel kufizimet e pushtetit të qeverisë. Shpjegoni pse.

5. Qeveria nuk ka të drejtë të hartojë ligje që në mënyrë të paarsyeshme dhe të padrejtë diskriminojnë njerëzit për shkak të racës, fesë, moshës, përkatësisë etnike ose origjinës kombëtare ose gjinisë. Politika e propozuar nga ne, i shkel/nuk i shkel kufizimet e pushtetit të qeverisë. Shpjegoni pse.

Deklaratë përmblledhëse

Në këtë deklaratë mbështesni bindjen tuaj se politika e propozuar nuk dhunon kushtetutën e vendit.





Grupi i portofolit: 4

ZHVILLIMI I NJË PLANI VEPRIMI

Grupi juaj është përgjegjës për zhvillimin e një plani veprimi. Ky plan duhet të përfshijë hapat që ju mund të merrni për të bërë që politika e propozuar nga ju, të pranohet dhe të zbatohet nga qeveria. E tërë klasa juaj duhet të përfshihet në zhvillimin e planit, por grupi juaj do të shpjegojë planin në Pjesën 4 të seksionit të afishimit dhe në Pjesën 4 të seksionit të dokumentimit të portofolit të klasës suaj.

A. AFISHIMI I PORTOFOLIT: PJESA 4

Kjo pjesë duhet të përfshijë pikat që vijojnë:

- a) **Një shpjegim me shkrim të mënyrës në të cilën klasa do të siguronte mbështetjen ndër individët dhe grupet e bashkësisë tuaj, për planin e propozuar nga ju.**

Për të realizuar këtë detyrë shfrytëzoni përgjigjet e fletës së punës me titull: Detyra 4 – “Zhvillimi i një plani veprimi” Në jo më shumë se dy faqe të shkruara, përshkruani pikat kryesore të planit tuaj.


- a) **Një shpjegim me shkrim të asaj se si klasa juaj mund të zhvillonte mbështetje nga qeveria juaj për planin propozuar nga ju.**

Në një faqe të shkruar përshkruani pikat kryesore të planit tuaj.

- b) **Paraqitjet grafike të planit tuaj të veprimit.**

Kjo mund të përfshijë tabela, grafikë, fotografi, vizatime, karikatura politike, tituj gazetash, tabela statistikash dhe ilustrime të tjera. Këto ilustrime mund të vijnë nga burime të shkruara ose mund të jenë krijimet tuaja origjinale. Secili prej ilustrimeve duhet të ketë një krye ose titull.

- c) **Identifikimi i burimeve tuaja të informacionit.**



Në një ose më shumë faqe të shkruara, identifikoni burimet që ka përdorur klasa për të mbledhur informacion.

B. DOKUMENTIMI I PORTOFOLIT: PJESA 4

Në Pjesën 4 të dosjes së klasës përfshini kopje të **informacionit më të mirë ose më të rëndësishëm** të mbledhur nga klasa dhe të përdorur për zhvillimin e planit propozuar nga ju. Për shembull, ju mund të përfshini si dokumentacion:

- deklarata të individëve ose grupeve me ndikim në bashkësi;
- deklarata të zyrtarëve dhe të agjencive qeveritare me ndikim;
- pjesë të përzgjedhura nga gazeta ose revista;
- raporte të shkruara të intervistave me njerëz në bashkësi;
- raporte të përzgjedhura të trajtimit të problemit nga radioja dhe televizioni;
- komunikata të përzgjedhura nga grupe interesi publike dhe private;
- pjesë nga botime qeveritare.

Dokumentet dhe raportet e gjata duhet të paraqiten nëpërmjet kopjeve të faqeve të tyre, të titullit, të tabelave të përmbajtjes dhe të një përmbledhjeje prej një faqe të dokumentit, të marrë prej tij ose të shkruara nga grupi. Sigurohuni të përgatisni një tabelë të përmbajtjes për këtë pjesë.

LISTA E KRITEREVE TË PORTOFOLIT - PËR ÇDO SEKSION

Plotësia


- A përfshin çdo pjesë e portofolit materialin e përfshirë në faqet për Grupet e portofolit 1-4?
- A keni përfshirë informacion më shumë se duhet?

Qartësia

- A është i organizuar mirë portofoli juaj?
- A është portofoli juaj i shkruar qartë, pa gabime gramatikore dhe ortografike?
- A kuptohen lehtësisht në të çështjet dhe argumentet kryesore?

Informacioni

- A është informacioni i saktë?

- 
- A lidhet informacioni i mbledhur me faktet dhe konceptet themelore?
 - A është informacioni që keni përfshirë i rëndësishëm për të kuptuar çështjen tuaj?

Mbështetja

A keni dhënë shembuj për të shpjeguar ose për të mbështetur çështjet tuaja kryesore?

A keni dhënë shpjegime tërësore për çështjet kryesore?

Grafikët

- A lidhen grafikët me përmbajtjen e seksionit tuaj?
- A përmbajnë informacion grafikët tuaja?
- A ka secili prej tyre një titull?
- A shërbejnë grafikët tuaj për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë paraqitjen tuaj?

Dokumentimi

- A i keni dokumentuar çështjet kryesore në pjesën e portofolit tuaj?
- A keni përdorur burime të besueshme dhe të vlefshme?
- Nëse keni cituar ndonjë burim informacioni, a e përmendni atë sa herë që duhet?
- A lidhet dokumentacioni juaj me paraqitjen që keni bërë?
- A keni përzgjedhur burimet më të mira dhe më të rëndësishme të informacionit?

Kushtetutshmëria

- A e keni përfshirë Formularin e opinionit kushtetues?
- A e keni shpjeguar pse politika që ju propozoni nuk e shkel kushtetutën?



LISTA E KRITEREVE TË PORTOFOLIT - PËR PORTOFOLIN NË TËRËSI

Argumentimi

- A jepen në portofolin tuaj shembuj të mjaftueshëm për të treguar se problemi që keni zgjedhur është i rëndësishëm?
- A i drejtohet politika që keni propozuar problemit në mënyrë të drejtpërdrejtë?
- A shpjegon portofoli juaj se si mund të fitoni mbështetjen publike për politikën që propozoni?

Vlera praktike

- A është politika juaj praktike dhe realiste?
- A është realist plani juaj për të fituar mbështetjen publike të politikës tuaj?

Bashkërendimi

- A lidhet secili prej katër pjesëve të portofolit tuaj me pjesët e tjera pa shkaktuar përsëritje të informacionit?
- A jepen, në pjesën e dokumentacionit dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur paraqitjen tuaj?

Reflektimi

- A dëshmon pjesa ku ju analizoni dhe vlerësoni zhvillimin e portofolit tuaj për faktin që ju e keni menduar mirë dhe keni reflektuar për përvojën e fituar?
- A dëshmon ajo që ju keni mësuar nga përvoja e zhvillimit të portofolit?



Hapi 5

PARAQITJA E PORTOFOLIT TUAJ

QËLLIMI I HAPIT V

Kur portofoli i klasës të jetë i plotësuar, ju mund ta paraqisni projektin tuaj para një grupi të caktuar njerëzish. Paraqitja juaj mund t'i bëhet një jurie prej tre ose katër personash që përfaqësojnë shkollën ose bashkësinë tuaj. Këta anëtarë të juriës do të “gjykojnë” paraqitjen tuaj duke u bazuar te të njëjtat kritere që ju përdorët për të zhvilluar portofolin tuaj. Kjo veprimtari do t'ju japë përvojë të vlefshme në paraqitjen e ideve tuaja, të tjerëve dhe në bindjen e tyre për qëndrimin tuaj

QËLLIMET

Kjo paraqitje shërben:

1. **Për të informuar** një grup të caktuar njerëzish për rëndësinë e problemit të identifikuar në bashkësinë tuaj.
2. **Për të shpjeguar** dhe për të vlerësuar politikat alternative në mënyrë që dëgjuesit të kuptojnë avantazhet dhe disavantazhet e secilës alternativë.
3. **Për të diskutuar** për zgjedhjen e klasës suaj, si politika, “më e mirë” për ta trajtuar problemin, dhe për të siguruar që politika e paraqitur nuk dhunon kushtetutën.
4. **Për të treguar** se si klasa juaj mund të sigurojë mbështetje për politikën e saj në bashkësi, si edhe në degët legjislative dhe ekzekutive të nivelit të përshtatshëm të qeverisë.

A. HAPJA (PARAQITJA GOJORE)

Gjatë katër minutave të para secili grup do të paraqesë gojarisht **informacionin që ai mendon më të rëndësishmin** nga pjesa e tij e portofolit.

1. Ai duhet të bazohet në seksionit të afishimit dhe të dokumentimit të portofolit, por nuk duhet të jetë një lexim falë për fjalë nga afishimi.
2. Ai duhet të përdorë grafika nga portofoli për të shpjeguar ose për të theksuar çështje të caktuara.

Gjatë paraqitjes gojore mund të paraqiten vetëm materiale të përfshira në portofolin tuaj. Ju nuk mund të paraqisni materiale shtesë të tilla si: videokaseta, demonstrime me kompjuter, diapozitiva etj..

B. SEANCA E PYETJEVE


Gjashtë minutat e tjera do të jenë një periudhë pyetjesh, gjatë të cilës një grup vlerësuesish do të pyesin grupin rreth paraqitjes së portofolit të tij. Gjatë kësaj periudhe vlerësuesit mund t'ju kërkojnë:

1. të shpjegoni ose të sqaroni më tej çështjet e paraqitura;
2. të jepni shembuj për çështje të veçanta;
3. të mbron disa prej thënieve ose qëndrimeve tuaja;
4. t'u përgjigjeni pyetjeve për atë që keni mësuar nga përvoja juaj:
 - Çfarë problemesh ndeshët?
 - Cilat ishin gjërat më të rëndësishme që mësuat, gjatë studimit të problemit të bashkësisë?

C. PËRGATITJA

Ju mund të pyesni prindërit tuaj ose anëtarë të tjerë të bashkësisë që kanë përvojë në realizimin e paraqitjeve publike për të stërvitur grupin tuaj. Njerëzit e përfshirë në qeverinë lokale ose në organizata të bashkësisë ose të qytetit mund të jenë shumë frytdhënës.

Praktikojeni paraqitjen tuaj gojore para audience të rriturish!



Provojeni atë para shokëve të klasës ose nxënësve të klasave të tjera!

D. UDHËZIME

Në realizimin e paraqitjes hapëse dhe në seancën e pyetjeve duhet të marrin pjesë anëtarët e grupeve sa më shumë të jetë e mundur.

Paraqitja gojore nuk duhet të mbizotërohet nga një ose dy nxënës. Ajo duhet të demonstrojë të mësuarit bashkëpunues që shkoi në përgatitjen e portofolit.

Mos u lexoni **gjykatësve** pjesë nga afishimi i portofolit tuaj. Përzgjidhni informacionin dhe argumentet më të rëndësishëm dhe paraqitini ato në një stil bashkëbisedues.

Ju mund të përdorni shënime gjatë në paraqitjes hapëse, por jo gjatë seancës së pyetjeve.

Në qoftë se nuk i përdorni të gjitha minutat e lejuara për paraqitjen hapëse, koha e papërdorur do t'i shtohet periudhës e pyetjeve pasuese. Secilit grup i jepen dhjetë minuta para gjykatësve.

Gjatë paraqitjes suaj gojore, mund të përdorni vetëm materiale të përfshira në portofolin e grupit tuaj

E. KRITERET E VLERËSIMIT

Në qoftë se klasa juaj vendos të hyjë në një konkurs me një paraqitje gojore, paraqitja juaj do të vlerësohet nga një grup vlerësuesish. Mësuesi juaj do të shpjegojë kriteret që do të përdoren për gjykimin e paraqitjeve.

Hapi 6

REFLEKTIMI PËR PËRVOJËN TUAJ MËSIMORE

Qëllimi

Është gjithmonë me vlerë ideja për të menduar ose për të reflektuar për përvojat që keni pasur ose projektet që keni realizuar. Kjo është një mënyrë për të mësuar, për të shmangur gabimet në të ardhmen dhe për të përmirësuar efektshmërinë e punës tuaj.

REFLEKTIMI

Pasi klasa juaj të ketë plotësuar portofolin e saj, shtoni një pjesë me mendimet ose vlerësimet tuaja për dosjen e pjesës së dokumentimit. Kjo pjesë e portofolit tuaj duhet të përshkruajë shkurtimisht:


- çfarë dhe si mësuar ju dhe shokët tuaj të klasës;
- çfarë mund të bënit ndryshe, në qoftë se do t'ju duhej të zhvillonit një portofol tjetër.

Reflektimi për përvojat tuaja duhet të jetë një përpjekje e përbashkët, e ngjashme me mënyrën se si keni punuar gjatë tërë projektit. Mendoni në të njëjtën kohë si individ dhe si anëtar i klasës suaj. Mësuesi juaj dhe të rriturit që ju ndihmuan të zhvillonit portofolin, mund t'ju ndihmojnë të reflektoni për përvojat tuaja në këtë projekt.


Mund të jetë e dobishme që t'ia paraqisni portofolin tuaj një grupi të caktuar njerëzish para se klasa juaj të zhvillojë këtë pjesë përfundimtare të portofolit. Pyetjet nga anëtarët e këtij grupi dhe reagimet e tyre ndaj portofolit tuaj, mund t'ju ndihmojnë të mendoni si për përvojat tuaja mësimore, ashtu edhe për portofolin që zhvilluat.

PËRFUNDIM

Është e rëndësishme që ju të vazhdoni të zhvillonit aftësitë që ju ndihmojnë të ndikoni në bërjen e politikës publike. Ju do t'i përdorni këto aftësi në të ardhmen. Mbani mend që, politikat publike shpesh herë kanë nevojë të rishikohen, kurse problemet e reja kanë nevojë për politika të reja publike.



Të ndihmuarit për të zhvilluar politika publike dhe marrja e qëndrimeve lidhur me to janë përgjegjësi jetësore të qytetarëve në një shoqëri të vet qeverisur.



UDHËZIME

Për të reflektuar për përvojën tuaj, mund t'ju ndihmojnë pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mësova **unë** personalisht rreth politikës publike nga të punuarit me shokët e mi të klasës?
- Çfarë mësuam ne si klasë rreth politikës publike, duke zhvilluar portofolin tonë?
- Çfarë aftësish mësova ose përmirësova **unë** në këtë projekt?
- Çfarë aftësish mësuam ose përmirësuam **ne** në këtë projekt?
- Cilat janë avantazhet e të punuarit në grup?
- Cilat janë disavantazhet e të punuarit në grup?
- Çfarë bëra mirë **unë**?
- Çfarë bëmë mirë **ne**?
- Si mund t'i përmirësoj **unë** aftësitë e mia për zgjidhjen e problemit?
- Si mund t'i përmirësojmë **ne** aftësitë tona për zgjidhjen e problemit?
- Çfarë mund të bënim ndryshe, në qoftë se do të na duhet të zhvillojmë një portofol tjetër për një çështje të politikës publike?



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

